

MREKULLITË E KURANIT

Botimi i 2të



“Me të vërtetë Kurani është
shpallje e Zotit të botëve.”

(Esh-Shu'ara 192)



HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)

Katërmbëdhjetë shekuj me parë, Zoti zbriti Kuranin, për të udhëzuar njerëzimin në rrugën e drejtë. Që nga dita e zbritjes së Tij e deri Ditën e Gjykimit, ky Libër i Shenjtë do të mbetet udhëzuesi i vetëm për njerëzimin. Stili i paarritshëm dhe Urtësia e përkryer që ndeshen në Kuran janë një provë e qartë e burimit hyjnor të këtij Libri. Por evidencat që provojnë saktësinë e Kuranit nuk mbarojnë me kaq; një nga këto evidenca është përmendja e një numri faktesh shkencore që janë zbuluar vetëm në sajë të teknologjisë së shekullit XX, ndërkohë që Kurani ka zbritur rreth 1400 vjet më parë. Sigurisht që këto fakte, as që mund të imagjinoheshin në kohën e zbritjes së Kuranit, gjë që e thekson akoma më tepër burimin hyjnor të Tij.

Libri që kenë në dorë, përveç mrekullive shkencore, përmban edhe disa mesazhe rreth të ardhmes, si dhe disa informacione historike të Kuranit.




DY FJALË RRETH AUTORIT:

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njeshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



Titulli i origjinalit
Miracles of the Qur'an
www.harunyahya.com

Të drejtat e botimit në gjuhën shqipe
janë të rezervuara për përkthyesin

Qershor 2010

Përkthimi:

Dritan Senja

Redaktimi letrar dhe teknik

Kujtim Ereqi

Korrektimi

Roald Hysa

Ornela Ademovi

Përkujdesja kompjuterike

Studio H. J. S.

Tel. +355 672244555

E-mail: libri_mrekullite@yahoo.com

Shtypur nga:

Secil Ofset

100. Yıl Mah. MASSİT Matbaacılar Sitesi

4. Cad. No: 77 Bağcılar -Istanbul / Turkey

Tel +90 212 6290615

MREKULLITË E KURANIT

*“Me të vërtetë Kurani është
shpallje e Zotit të botëve.”*

(Esh-Shu'ara 192)

Harun Jahja (Adnan Oktar)

DY FJALË RRETH AUTORIT DHE VEPRAVE TË TIJ

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjas së, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e

udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të

Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrëhinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë

"fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo

kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën

e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut

qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë

dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të

qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë

një qëllim të përbashkët: të japin

mesazhin e Kur'anit, të

inkurajojnë lexuesit për të

menduar mbi çështje që kanë

të bëjnë me besimin, si

për shembull,

ekzistenca e

Allahut dhe

njëshmëria



e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeya kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

PËRMBAJTJA

MREKULLITË SHKENCORE NË KURAN8
PARATHËNIE10
KRIJIMI I UNIVERSIT12
ZGJERIMI I UNIVERSIT14
NDARJA E QIEJVE DHE E TOKËS16
ORBITAT18
RRUMBULLAKSIA E TOKËS21
ÇATI E SIGURTË22
QIELLI KTHYES26
FUNKSIONI I MALEVE28
LËVIZJA E MALEVE32
MREKULLIA E HEKURIT34
KRIJIMI NË ÇIFT35
RELATIVITETI I KOHËS36
SASIA E SHIUT38
FORMIMI I SHIUT40
ERËRAT FEKONDUESE44
DETET NUK PËRZIHEN ME NJËRI-TJETRIN46



ERRËSIRAT E DETEVE DHE VALËT E BRENDSHME	48
ZONA E TRURIT QE KONTROLLON LËVIZJEN	51
KRIJIMI I NJERIUT	52
QUMËSHTI I NËNËS	62
IDENTITETI NË SHENJAT E GISHTËRINJVE	63
INFORMACIONI I DHËNË NË KURAN MBI TË ARDHMEN	64
PARATHENIE	65
FITORJA E BIZANTIT	66
INFORMACIONET HISTORIKE NË KURAN	70
FJALA "HAMAN" NË KURAN	71
TITUJT E SUNDUESVE EGJIPTIANË NË KURAN	74
KONKLUZION	76
DISFATA E EVOLUCIONIT	78





**MREKULLITË
SHKENCORE
NË KURAN**

PARATHËNIE

Katërmëdhjetë shekuj më parë, Zoti zbriti Kuranin. Ky libër udhëzues e plot urtësi i thërret njerëzit për në rrugën e vërtetë dhe i mëson ata të përqafojnë vlerat të cilat mbart kjo shpallje madhështore. Që prej ditës së shpalljes së tij e deri në Ditën e Gjykimit, ky libër i fundit hyjnor do të mbesë udhëzimi i vetëm për ta.

Në librin e Allahut shpallet:

**“ Po ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se
këshillë për botën (e njerëzve e të xhinëve). ”**

(El Kalem 52)

Që kur Kurani është shpallur, ai ka zotëruar një gjuhë e tingull të lehtë për t'u kuptuar, të arritshëm për të gjithë njerëzit në të gjitha kohërat. Allahu na tregon për këtë stil në Kuran: **“Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për ta mbajtur mend...”** (E Kamer 22)

Përsosmëria e gjuhës letrare të Kuranit, anët e pakrahasueshme të stilit të tij dhe urtësia e lartë që ai përmban, janë disa prej provave përfundimtare se ai paraqet fjalën e Zotit tonë.

Veç kësaj, Kurani përmban brenda fjalëve të tij shumë mrekulli që provojnë se ai është fjalë e Allahut. Një nga këto cilësi është numri i jashtëzakonshëm i të vërtetave shkencore që gjenden në Librin e Islamit. Në këtë libër, që iu shpall më shumë se katërmëdhjetë shekuj më parë Profetit Muhamed (p.q.m.t.), ka shembuj të panumërt të të dhënave që njerëzimi ka mundur t'i zbulojë vetëm nëpërmjet teknologjisë së shekujve të 20-të e të 21-të.

Sigurisht, ne nuk duhet ta shohim Kuranin si një libër shkencor, pasi ai, së pari, është një libër për udhëzim moral e shpirtëror. Sidoqoftë, shumë të vërteta shkencore që janë shprehur në mënyrë të saktë e të thellë brenda

vargjeve të Kuranit, janë zbuluar nga shkencëtarët vetëm në saj të përparimit teknologjik të shekujve të 20-të dhe të 21-të. Fare thjesht, këto të vërteta që ne po ia paraqesim lexuesit, nuk mund të njiheshin në kohën e shpalljes së Kuranit dhe kjo përbën një tjetër provë se Kurani është fjalë e Allahut.

Për të kuptuar mrekullitë shkencore që përmban Kurani, ne duhet të njihemi, së pari, me nivelin shkencor që ekzistonte në kohën kur ky libër i shenjtë iu zbulua njerëzimit. Nëse kuptojmë kontekstin, në të cilin u shpall Kurani, mund ta kuptojmë më mirë se sa i jashtëzakonshëm është, në të vërtetë, libri i Islamit.

Në shekullin e 7-të, kur u zbritën këto vargje të shenjta, shoqëria arabe ishte e rrahur prej plot bestytnish e besimesh të pabaza. Duke mos zotëruar ndonjë teknologji për të analizuar gjithësinë dhe natyrën, këta arabë të hershëm besonin në historira të pavërtetuara, të trashëguara nga brezat e shkuar, dhe as që i vinin në dyshim ato.


Për shembull, ata besonin se Toka ishte e sheshtë dhe se malet vepronin si shtylla që mbanin kupën e qiellit lart, mbi ne.

Në këtë atmosferë gojëdhënash e mitesh, zbriti Kurani. Ai zëvendësoi paditurinë me dijen dhe hamendjet e paarsyeshme me udhëzimin dhe sigurinë. Një varg i Kuranit thotë: **“Allahu është Ai që ngriti lart qiejt pa ndonjë mbështetëse...”** (Er-Rad 2)

Ky ajet hodhi poshtë besimin e trashëguar të arabëve se qielli qëndron lart i mbajtur prej maleve. Në Kuran gjenden fakte tepër të rëndësishme dhe të sakta, të cilat janë shpallur në një kohë kur njerëzimi nuk zotëronte ndonjë njohuri për to. Kurani, i cili zbriti në kohën kur njerëzit dinin shumë pak rreth astronomisë, fizikës ose biologjisë, përmban argumente bazë mbi një sërë dukurish të ndryshme, e të gjitha këto janë fakte se ky libër është shpallje nga Allahu, Zoti i të gjithë Botëve. Disa prej këtyre dukurive të shpjeguara dhe të shqyrtuara në Kuran janë: krijimi i Universit, krijimi dhe zhvillimi i mrekullueshëm i qenieve njerëzore që prej formimit të embrionit mjaft të vogël e deri në rritje, struktura e atmosferës në të cilën ne jetojmë apo ekuilibri delikat, i cili bën të mundur jetën në Tokë.

Me qëllim që të kuptojmë sa më mirë disa prej këtyre dukurive, le të shqyrtojmë së bashku disa prej këtyre mrekullive shkencore të shpallura në Kuran.

*Këtë libër të begatshëm Ne ta
shpallëm ty me qëllim që t'i
studiojnë argumentet e tij dhe të
marrin mësim prej tij,
ata që kanë mend.
(Sad 29)*




KRIJIMI I UNIVERSIT

Deri në mesin e shekullit të 20-të, pikëpamja mbizotëruese për botën ishte se gjithësia është e pafundme, se ka ekzistuar gjithmonë e do të vazhdojë të ekzistojë për gjithë kohën. Sipas kësaj pikëpamjeje, të njohur si “modeli i universit statik”, gjithësia nuk ka as fund e as fillim.

Duke pohuar se gjithësia është një grumbullim lëndësh të caktuara, të qëndrueshme e të pandryshueshme, kjo pikëpamje përbënte bazën e filozofisë materialiste dhe ka mohuar vazhdimisht ekzistencën e një Krijuesi. Sidoqoftë, me përparimin e shkencës e të teknologjisë gjatë shekullit të 20-të, modeli i universit statik u çrrënjësua plotësisht.

Tashmë kemi hyrë në shekullin e 21-të dhe një agim i ri ka lindur. Përmes eksperimentesh, vëzhgimesh e llogaritjesh të panumërta, të kryera prej disa mendimtarëve më të shquar të botës, fizika bashkëkohore ka provuar se gjithësia, në të vërtetë, e ka pasur një fillim, se ajo ka ardhur në ekzistencë nga asgjëja në një çast të vetëm të një shpërthimi të jashtëzakonshëm.

Veç kësaj, është arritur në përfundimin se gjithësia nuk është e pandryshueshme dhe statike, sikurse pohojnë ende me këmbëngulje materialistët. Përkundrazi, ajo po kalon në një proces lëvizjeje, ndryshimi e zgjerimi. Sot, të gjitha këto të vërteta janë të pranuar gjerësisht nga komuniteti i shkencëtarëve.



Aparaturat e ndjeshme në bordin e satelitit hapësinor COBE, i cili u lëshua nga NASA më 1992, arriti të kapte dukshëm pjesë të mbetura të Big Bengut. Ky zbulim shërben si dëshmi për Big Bengun, i cili është shpjegimi shkencor i faktit se universi u krijua nga asgjëja.

Në ajetin e mëposhtëm, përshkruhet origjina e universit:

“ Ai krijoi qiejt e Tokën (pa pasur asnjë shembull)... ”

(El-En'am 101)

Ky informacion është në përputhje të plotë me zbulimet e shkencës bashkëkohore. Ashtu siç e thamë edhe më lart, përfundimi në të cilin ka arritur astrofizika sot është se, i tërë universi, së bashku me dimensionet e lëndës dhe të kohës, erdhi në ekzistencë si rezultat i një shpërthimi të madh, i cili ndodhi shumë kohë më parë dhe menjëherë. Ky fenomen i njohur me emrin “Big Beng”, është zanafilla e krijimit të universit nga asgjëja. Mbarë komuniteti shkencor është në një mendje se ky shpërthim ndodhi në një pikë të vetme rreth 15 miliard vite më parë. (Shih në librin Krijimi i Universit të autorit Harun Jahja botuar në gjuhën shqipe)



ZGJERIMI I UNIVERSIT

Në Kuran, i cili u shpall 14 shekuj më parë, në kohën kur shkenca e astronomisë ishte akoma primitive, zgjerimi i universit përshkruhet në këtë mënyrë:

“ Ne me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe jemi Ne që e zgjerojmë atë. ”

(Edh-Dharijat 47)

Fjala “qiell” e përmendur në ajetin e mësipërm është përdorur në vende të ndryshme në Kuran. Ajo nënkupton hapësirën dhe një univers në zgjerim. Këtu, përsëri, fjala është përdorur në këtë kuptim, duke shpallur se gjithësia “**zgjerohet**”. Fjala arabe “musi’una” në shprehjen “inna lemusi’una”, e përkthyer “**jemi Ne që e zgjerojmë atë**”, vjen nga folja “evse’e”, që do të thotë “zgjerohet”. Parashtesa “le”, thekson emrin apo titullin që pason dhe shton kuptimin “*në një shkallë të madhe*”. Ky është vetë përfundimi që shkenca ka arritur sot.¹

Deri para fillimit të shekullit XX, i vetmi mendim i përhapur në të gjithë botën e shkencës ishte se “universi ruan një gjendje konstante dhe ka ekzistuar përherë pa fillim”. Por kërkimet, vëzhgimet dhe rezultatet e marra prej aparaturave moderne vërtetuan se universi në të vërtetë ka një fillim; Sidoqoftë, kërkimet, vëzhgimet dhe përlogaritjet, të kryera nëpërmjet teknologjisë bashkëkohore, vërtetojnë se gjithësia, në të vërtetë, kishte një fillim dhe se ajo në mënyrë të vazhdueshme, “zgjerohet”.

Në fillimet e shekullit XX, fizikanti rus Alexander Friedmann dhe kozmologu belg Georges Lemaitre llogaritën teorikisht se **universi është në lëvizje të vazhdueshme dhe zgjerohet**.

Ky nocion rrodhi si rezultat i vëzhgimeve të kryera në vitin 1929. Astronauti amerikan Edvin Habëll, ndërsa po vëzhgonte qiellin me një teleskop, zbuloi se yjet dhe galaktikat largoheshin vazhdimisht nga njëra-tjetra.

Ky zbulim është vlerësuar si një ndër më të



Edwin Hubble me teleskopin e tij gjigand



Georges Lemaitre



Që prej momentit të Big Bengut, universi ka filluar të zgjerohet vazhdimisht me shpejtësi të madhe. Shkencëtarët e krahasojnë zgjerimin e universit me sipërfaqen e një tullumbaceje në fryrje e sipër.

rëndësishmit e historisë së astronomisë. Gjatë këtyre vëzhgimeve Edvin Habëll saktësoi se yjet përcjellin një dritë që bëhet gjithnjë e më e kuqe, sipas largësisë. Kjo ndodh, për arsye se sipas ligjeve të njohura të fizikës, drita që

niset drejt një pike të caktuar vëzhgimi, kthehet në vjollcë, ndërsa drita që largohet nga ajo pikë merr një ngjyrim më të kuqëluar. Gjatë vëzhgimeve të tij, Habëlli vuri re prirjen drejt ngjyrës së kuqe në dritën e përcjellë nga yjet. Shkurt, yjet po largoheshin prej nesh gjithnjë e më tutje. Ai zbuloi gjithashtu se yjet dhe galaktikat nuk largoheshin vetëm prej nesh, por edhe nga njëri-tjetri. Një univers, ku çdo gjë lëviz vazhdimisht duke u larguar prej çdo gjëje tjetër, nënkupton **një univers vazhdimisht në zgjerim**. Vëzhgimet e kryera në vitet në vazhdim vërtetuan se universi është në zgjerim e sipër.

Për ta kuptuar më qartë këtë, mund ta përfytyrojmë gjithësinë si sipërfaqen e një tullumbaceje që po fryhet. Sa më shumë që tullumbacja të fryhet, aq më shumë largohen nga njëra tjetra pikat mbi sipërfaqen e saj. Në të njëjtën mënyrë, edhe trupat qiellorë i largohen njëri-tjetrit me zgjerimin e gjithësisë. Kjo u zbulua teorikisht nga Albert Ajnshtajn, që njihet si një ndër shkencëtarët më të mëdhenj të shekullit të 20-të. Megjithatë, për të shmangur shkeljen e “modelit të universit statik”, që ishte i pranuar gjerësisht në atë kohë, Ajnshtajni e la zbulimin e tij mënjanë. Ai do ta përshkruante këtë më vonë si gabimin më të madh të jetës së tij.²

Ky fakt është shpjeguar në Kuran në një kohë kur teleskopët dhe përparime të ngjashme teknologjike as që mendohej se do të zbuloheshin. Kjo ndodh për arsye se Kurani është fjalë e Allahut, Krijuesit dhe Sunduesit të gjithë universit.

NDARJA E QIEJVE DHE E TOKËS

Një prej ajeteve që bën fjalë për krijimin e qiejve është edhe ajeti i mëposhtëm:


**” A nuk e dinë jobesimtarët se qiejtë dhe Toka ishin të ngjitura,
e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të
jetës së çdo gjëje. Përse nuk besojnë pra? ”**

(El Enbija 30)

Fjala “*retk*”, e përkthyer “**të ngjitura**”, në gjuhën arabe do të thotë “të përziera me njëra-tjetrën, të bashkuara”. Kjo fjalë përdoret në ato raste kur u referohemi dy substancave të ndryshme, të cilat përbëjnë një të plotë. Frazja “**Ne i ndamë**” është folja arabe “*feteka*” dhe nënkupton diçka që vjen si rezultat i shkëputjes apo shkatërrimit të strukturës së substancave të ngjitura me njëra-tjetrën. Çarja e farës së bimës në momentet para mbirjes është një nga rastet në të cilat përdoret kjo folje.

Le të shqyrtojmë përsëri ajetin kuranor. Në ajet, qielli dhe toka janë subjekti i parë i gjendjes “*retk*”. Më pas ata ndahen (*feteka*), duke u shkëputur nga njëri-tjetri. Kureshtja jonë rritet kur mendojmë rreth momentit fillestar të Big Bengut dhe shohim se e gjithë lënda e universit përfshihet në një pikë të vetme. Me fjalë të tjera, çdo gjë, duke përfshirë “qiejt dhe tokën”, të cilat nuk ishin krijuar ende, ishin pjesë e kësaj pike në një gjendje të pandarë. Më pas, një shpërthim i fuqishëm i kësaj pike, bëri që lënda e saj të ndahet.

Fotoja paraqet Big Bengun, i cili bën të qartë edhe një herë se Zoti e krijoi universin prej asgjëse. Big Bengu është një teori e vërtetuar me dëshmi të qarta shkencore. Megjithëse disa shkencëtarë u përpoqën të sillnin teori të kundërta me Big Bengun, dëshmitë e qarta shkencore bënë që kjo teori të pranohej tërësisht prej komunitetit shkencor.



ORBITAT


Një ndër argumentet më të rëndësishëm për baraspeshën madhështore në gjithësi, është fakti se trupat qiellorë ndjekin rrugë të caktuara. Yjet, planetet dhe satelitët që të gjithë rrotullohen përqark boshteve të tyre dhe rrotullohen, gjithashtu, bashkë me sistemin ku bëjnë pjesë. Gjithësia vepron brenda një rregulli të përcaktuar me përsosmëri, njëlloj si ingranazhet e një fabrike.

Në gjithësinë e dukshme, gjenden më shumë se 100 miliardë galaktika dhe çdo galaktikë e vogël përmban afro një miliard yje. Për më tepër, çdo galaktikë e madhe përmban një trilion.³ Shumë prej këtyre yjeve kanë planete dhe shumë prej atyre planeteve kanë satelitë. Të gjithë këta trupa qiellorë ndjekin rrugët dhe orbitat e llogaritura në mënyrën më të hollësishtme. Për miliona vjet, secili prej tyre ka lëvizur në rrugën e vet, në një harmoni të përkryer me të gjithë të tjerët. Krahas këtyre, gjenden edhe shumë kometa që lëvizin në rrugët e tyre të paracaktuara.

Për më tepër, rrugët në gjithësi nuk janë të kufizuara vetëm për pak trupa qiellorë. Sistemi Diellor dhe, madje, galaktika të tjera shfaqin lëvizje të ndjeshme përreth qendrave të tjera. Çdo vit, Toka dhe Sistemi Diellor bashkë me të, lëvizin afro 500 milionë km nga vendi ku kishin qenë një vit më parë. Është përlllogaritur se edhe shmangia më e vogël e rrugëve të trupave qiellorë mund të kishte pasoja të konsiderueshme, që mund të çonin në fundin e të gjithë sistemit. Për shembull, pasojat e shmangies së tokës nga udha e saj vetëm për 3 mm janë përshkruar në një burim si më poshtë:

Ndërsa rrotullohet rreth diellit, toka ndjek një orbitë që, për çdo 18 milje, shmanget vetëm 2.8 milimetra nga kursi i saj i drejtpërdrejtë. Orbita e ndjekur nga toka nuk ndryshon kurrë, sepse edhe një shmangie prej 3 milimetrash do të sillte shkatërrime katastrofike: nëse shmangia do të ishte 2.5 mm nga 2.8 mm, atëherë orbita do të ishte shumë e gjerë dhe të gjithë ne do të kishim ngrirë. Nëse shmangia do të ishte 3.1 mm, ne do të kishim vdekur të përvëlur.⁴

Një tjetër karakteristikë e trupave qiellorë është se ata, gjithashtu, rrotullohen përqark boshteve të veta. Vargu që thotë **"Betohem në qiellin**



me sistemet e tij ciklike” (Et-Tarik 11), na e tregon këtë të vërtetë. Natyrisht, në kohën kur shpallej Kurani, njerëzit nuk kishin teleskopë për të studiuar trupa që ndodheshin miliona kilometra larg në hapësirë, teknologjinë e përparuar të vëzhgimit apo njohuritë tona bashkëkohore të fizikës e të astronomisë. Për këtë arsye, ishte e pamundur të thuhej se hapësira ka **“orbitat e tij luhatëse.”** (Edh-Dharijat 7) siç është përshkruar në këtë varg. Kurani, sidoqoftë, megjithëse i shpallur në atë kohë, na siguron të dhëna të qarta në lidhje me këtë të vërtetë. Kjo përbën një provë se ky libër është vërtet fjalë e Allahut.



Si shumë kometa të tjera në univers, edhe kometa Halley (Iart) lëviz në një orbitë të përcaktuar. Ajo ka një orbitë specifike dhe lëviz në harmoni të plotë me trupat e tjerë qiellorë.

Të gjithë trupat qiellorë, duke përfshirë edhe planetet, satelitët, yjet, madje dhe galaktikat, kanë orbitat e tyre, të përcaktuara me llogaritje tepër delikate. Ai që vendosi këtë rregull dhe ekuilibër të përkryer është Zoti, Krijuesi i universit.

RRUMBULLAKSIA E TOKËS


“ Ai i krijoi qiejt e Tokën me qëllim të caktuar. Ai ia mbështjell natën ditës dhe ditën ia mbështjell natës.”

(Ez-Zumer 5)

Fjalët e përdorura në Kuran për të përshkruar universin janë mjaft të qarta. Fjala arabe, e cila është përkthyer “mbështjellë” në ajetin e mësipërm, është fjala “*jukauuir*”. Në fjalorët arabë, kjo fjalë përdoret për të përshkruar mbështjelljen e një gjëje rreth një gjëje tjetër, siç mbështillet çallma rreth kokës.

Njoftimi i dhënë në këtë ajet për mbështjelljen e ditës dhe natës me njëra-tjetrën na ndihmon të njohim formën e tokës. Kjo mbështjellje mund të ndodhë vetëm nëse Toka është e rrumbullakët. Kjo do të thotë se rrumbullakësia e tokës është thënë në mënyrë të tërthortë në Kuran, që në shekullin VII. Nuk duhet të harrojmë se gjuha arabe është një gjuhë shumë e pasur dhe përdorimi i kësaj foljeje është i rrallë, gjë që tregon fare qartë se përdorimi i saj është bërë me qëllim.

Sidoqoftë, ne duhet të sjellim ndërmend se njohuritë e astronomisë të asaj kohe e perceptonin botën krejt ndryshe. Atëherë mendohej se bota ishte një plan i sheshtë dhe të gjitha përlllogaritjet dhe shpjegimet shkencore ishin të bazuara mbi këtë besim. Sidoqoftë në Kuranin famëlartë gjenden fjalët përshkruese më të sakta, kur flitet për përshkrimin e universit. Këto të vërteta, të cilat ne arritëm t'i kuptonim në mënyrë të saktë, vetëm në shekullin tonë, kanë qenë në Kuran mjaft shekuj më parë.



ÇATI E SIGURTË

Në Kuran, Zoti na tërheq vëmendjen ndaj një vetie mjaft të rëndësishme të qiellit:

“ Qiellin e kemi bërë si çati të sigurtë e të mbrojtur, por ata zbrapsen prej këtyre argumenteve...”

(El Enbija 32)

Kjo veti e qiellit është vërtetuar prej kërkimeve shkencore të kryera në shekullin XX.

Atmosfera, e cila rrethon Tokën, kryen shërbime jetike për të siguruar vazhdimësinë e jetës. Duke shkatërruar mjaft meteorë të mëdhenj e të vegjël, gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur Tokën, ajo i ndalon ata që të përplasen me Tokën dhe të dëmtojnë gjallesat.

Për më tepër, atmosfera filtron rrezet e dritës që vijnë nga hapësira, të cilat janë të dëmshme për krijesat e gjalla. Vetia më interesante e kësaj dukurie është se vetëm rrezet e padëmshme e të nevojshme - drita e tejdukshme, rrezet e shkurtra ultravjollcë dhe valët e radios - janë në gjendje të përshkojnë atmosferën. I gjithë ky rrezatim është i domosdoshëm për jetën. Atmosfera lejon kalimin vetëm të një pjese të rrezeve të shkurtra ultravjollcë, të cilat janë mjaft të domosdoshme për procesin e fotosintezës dhe për ekzistencën e të gjitha gjallesave. Pjesa më e madhe e rrezeve të gjata ultravjollcë, të lëshuara nga Dielli, filtrohen prej shtresës së ozonit në atmosferë dhe vetëm një pjesë e kufizuar dhe thelbësore e tyre arrijnë në Tokë.

Vetia mbrojtëse e atmosferës nuk mbaron këtu. Atmosfera mbron gjithashtu tokën prej të ftohtit ngrirës të hapësirës, i cili arrin rreth -270°C (-454°F).

Nuk është vetëm atmosfera ajo që e mbron Tokën nga efektet shkatërruese dhe dëmtuese të hapësirës.




Atmosfera lejon që të arrijnë në Tokë vetëm rrezet e nevojshme për jetën. Për shembull, rrezet ultravjollcë arrijnë në Tokë në një përpjestim të caktuar. Vetëm në sajë të këtij fakti është e mundur kryerja e procesit të fotosintezës dhe, rrjedhimisht, vazhdimësia e jetës për të gjitha gjallesat.



Ky ilustrim paraqet meteorët që janë gati për t'u përplasur me tokën. Trupat qiellorë, gjatë udhëtimit në hapësirë, mund të përbëjnë një kërcënim serioz për Tokën, por Zoti, i Cili ka krijuar çdo gjë në mënyrën më të përkryer, e ka bërë atmosferën një "çati mbrojtëse". Falë kësaj mbrojtjeje të përkryer, gati të gjithë meteorët nuk mund ta dëmtojnë Tokën, sepse kur arrijnë atmosferën, ata shpërbëhen në miliona copa të vogla.



Pjesa më e madhe e njerëzve, kur shohin qiellin, nuk mendojnë rreth vetive mbrojtëse të atmosferës. Ata thajse nuk mendojnë kurrë se çfarë vendi do ishte Toka, nëse kjo strukturë nuk do të ekzistonte. Fotografia lart paraqet një krater gjigand të krijuar nga një meteor, i cili ra në Arizona, në SHBA. Sikur të mos ekzistonte atmosfera, miliona meteorë do të binin në Tokë dhe ajo do të bëhej një vend i pabanueshëm. Por vetitë mbrojtëse të atmosferës bëjnë të mundur që gjallesat të jetojnë të sigurt. Kjo është pikërisht mbrojtja që është shpallur në Kuran.



Energjia që çlirohet nga një shpërthim diellor është kaq e madhe, saqë mendja e njeriut e ka të vështirë ta konceptojë. Një shpërthim i vetëm është i barabartë me energjinë e çliruar nga 100 miliardë bomba atomike si ajo e hedhur në Hiroshimë. Bota është e mbrojtur nga efektet shkatërruese të kësaj energjie prej atmosferës dhe brezit rrethues Van Alen.



Duke u larguar prej Tokës, e cila është e përshtatur në mënyrë të përsosur për jetën njerëzore, përtej atmosferës, në hapësirë, ne hasim një të ftohtë ngrirës. Bota është e mbrojtur prej të ftohtët ngrirës të hapësirës, i cili arrin në -270°C , në saje të atmosferës.



Shtresa magnetosferike e formuar prej fushës magnetike të Tokës i shërben asaj si një fushë mbrojtëse prej trupave qiellorë dhe rrezeve kozmike të dëmshme. Në foton lart duket qartë kjo shtresë magnetosferike, e cila quhet ndryshe Brezi Van Alen. Ky brez rrethues ndodhet mijëra kilometra larg Tokës dhe mbron të gjitha krijesat në tokë prej energjisë shkatërruese që vjen nga hapësira. Të gjitha këto zbulime shkencore vërtetojnë se Toka është e mbrojtur në një mënyrë tepër të veçantë. Gjëja më e rëndësishme është se kjo “mbrojtje” na u bë e njohur në Kuran 1400 vjet më parë, në ajetin: “Qiellin e kemi bërë çati të sigurtë e të mbrojtur.”

Së bashku me atmosferën, brezi Van Alen, një shtresë, e cila krijohet si rezultat i fushës magnetike të Tokës, gjithashtu shërben si një fushë mbrojtëse kundër rrezatimeve të dëmshme, të cilat kërcënojnë planetin tonë. Ky rrezatim, i cili vazhdimisht lëshohet prej diellit dhe yjeve të tjera, është vdekjeprurës për gjallesat. Nëse brezi Van Alen nuk do të ekzistonte, energjia e shpërthimeve masive të quajtura shpërthime diellore, të cilat hasen vazhdimisht në Diell, do të shkatërronin çdo formë jete në Tokë.

Duke folur mbi rëndësinë që ka për jetën tonë brezi Van Alen, Dr. Hugh Ross ndër të tjera thotë:

“Në fakt, Toka ka dendësinë më të lartë se çdo planet tjetër në Sistemin Diellor. Bërthama e madhe e hekur-nikelit është shkaku i ekzistencës së fushës sonë të madhe magnetike. Kjo fushë magnetike formon shtresën mbrojtëse Van-Alen, e cila e mbron Tokën nga rrezet bombarduese. Nëse nuk do të ishte kjo mburojë, jeta në Tokë do të ishte e pamundur. I vetmi planet tjetër shkëmbor që ka fushë magnetike është Merkuri, por fuqia e fushës së tij është 100 herë më e vogël se e Tokës. Madje as Afërdita – planeti ynë “motër” – nuk ka fushë magnetike. Brezi mbrojtës Van-Alen është një strukturë që gjendet vetëm në Tokë.”⁵

Energjia e çliruar në një prej këtyre shpërthimeve të viteve të fundit është e barabartë me energjinë e çliruar nga shpërthimi i 100 miliardë bombave atomike, secila e ngjashme me atë që u hodh në Hiroshimë në fund të Luftës së Dytë Botërore. Pesëdhjetë e tetë orë pas shpërthimit u vërejt se gjilpërat magnetike të busullave paraqitnin një lëvizje jo të zakonshme dhe 250 km (155 milje) mbi atmosferën e Tokës, temperatura u rrit menjëherë në 2500°C (4532°F).

Me pak fjalë, një sistem mbrojtës i përkryer funksionon mbi Tokë. Ai e rrethon botën tonë dhe e mbron prej kërcënimeve të jashtme. Vetëm kohët e fundit, shkencëtarët arritën të mësojnë disa gjëra rreth tij, kurse Zoti na ka njoftuar në Kuran për mbështjellën mbrojtëse të Tokës që shekuj më parë.



QIELLI KTHYES

Ajeti i njëmbëdhjetë i sures Et-Tarik në Kuran, i referohet vetisë “kthyesë” të qiellit:

“**Betohem në qiellin që kthen.**”

(Et-Tarik 11)

Fjala “raxh” që nënkupton “kthim” në përkthimet e Kuranit ka kuptimin e “dërgimit mbrapa” apo të “kthimit mbrapa”. Siç dihet, atmosfera, e cila rrethon Tokën, përbëhet nga disa shtresa. Secila prej tyre luan një rol të rëndësishëm në dobi të jetës. Kërkimet kanë nxjerrë në dritë se këto shtresa janë të specializuara në kthimin mbrapsht të trupave apo rrezeve që vijnë nga hapësira apo nga vetë Toka. Tani le të shqyrtojmë disa shembuj të këtij funksioni “kthyes” të shtresave që e rrethojnë Tokën.


Troposfera, e cila ndodhet 13-15 km mbi Tokë, luan rol në kondensimin e avujve të ujit që vijnë nga sipërfaqja e Tokës dhe në **kthimin poshtë** të tyre në formë shiu.

Shtresa e ozonit, shtresa më e ulët e stratosferës, me lartësi 25 km nga toka reflekton rrezatimin e dëmshëm dhe rrezet ultravjollcë, të cilat vijnë nga hapësira dhe i **kthen mbrapsht** në hapësirë.

Jonosfera **kthen** valët e radios të transmetuara nga Toka duke i **kthyer poshtë** në pjesë të ndryshme të saj, tamam si një satelit pasiv komunikimi. Kështu kjo shtresë bën të mundur transmetimin e valëve radiofonike dhe televizive në një distancë tepër të largët.

Shtresa magnetosferike **kthen mbrapsht** grimcat e dëmshme radioaktive që përhapen nga Dielli dhe yjet e tjera, para se të arrijnë Tokën.


Fakti që gjithë këto veti të shtresave të atmosferës, të zbuluara vetëm kohët e fundit, janë shpallur në Kuran prej shumë shekujsh provon bindshëm se Kurani është fjala e Zotit.



Prania e ujit është mjaft e rëndësishme për jetën në Tokë. Një nga faktorët që ndikon në formimin e ujit është Troposfera, e cila është një prej shtresave të atmosferës. Shtresa e Troposferës kondenson ujin që vjen në gjendje avujsh nga sipërfaqja e Tokës dhe e kthen poshtë në formë shiu.



Shtresa atmosferike, e cila bllokoi rrezet që mund të jenë shkatërruese për jetën në Tokë, është Ozonosfera. Ajo kthen rrezet e dëmshme të ardhura nga hapësira, siç janë rrezet ultravjollcë, duke parandaluar arritjen e tyre në Tokë.




Secila shtresë e atmosferës ka veti të dobishme për jetën e krijesave. Shtresa e Jonosferës, për shembull, e cila është një nga shtresat më të larta të atmosferës, kthen valët e radios të lëshuara nga një qendër e caktuar poshtë në Tokë dhe bën të mundur kapjen e këtyre valëve në distanca të mëdha.

FUNKSIONI I MALEVE


Kurani na t rheq v mendjen ndaj nj  funksioni gjeologjik mjaft t  r nd sish m t  maleve.

“ Ne kemi krijuar male t  patundura n  tok , me q llim q  ajo t  mos l kundet dhe tronditet bashk  me ta... ”


(El Enbija 31)



Malet kan  rrenj  t  thella n n sip rfaqen e tok s. (Earth, Press & Siever, fq. 413)



Spektori skematik. Malet, si kunjat, kan  rrenj  t  thella t  fiksuar n  tok . (Anatomia e Tok s, Cailleux fq. 220)



Nj  ilustrim tjet r na tregon se malet kan  form n e kunjave, n  saje t  thell sis  s  rrenj ve t  tyre. (Shkenca e Tok s, Tarbuck & Lutgens, fq. 158)



Siç vihet re, në këtë ajet është shpallur se malet luajnë rol në parandalimin e tronditjeve dhe lëkundjeve të Tokës.

Ky fakt nuk ishte i njohur nga askush në kohën kur u shpall Kurani. Në të vërtetë, ai u zbulua jo shumë kohë më parë dhe kjo vetëm si rezultat i zbulimeve të gjeologjisë bashkëkohore.

Sipas këtyre zbulimeve, malet shfaqen si rezultat i lëvizjeve dhe përplasjeve të shtresave masive, të cilat formojnë koren e Tokës. Kur dy shtresa përplasen me njëra-tjetrën, shtresa më e fortë rrëshqet poshtë shtresës tjetër, e cila përkulet në majë, duke formuar lartësitë dhe malet. Shtresa e poshtme fillon e zgjerohet duke u shtrirë thellë në tokë. Kjo nënkupton se pjesa e poshtme e maleve është po aq e madhe sa edhe pjesa e dukshme mbi Tokë.

Në saje të shtrirjes nën tokë dhe mbi tokë, malet i mbërthejnë shtresat e ndryshme të tokës si një kunj. Korja e Tokës përmban shtresa që janë në lëvizje të vazhdueshme. Kjo veti mbërthyesë e maleve parandalon tronditjet me shtrirje të gjerë, duke e fiksuar koren e tokës, e cila ka një strukturë tepër të lëvizshme.





Në një tekst shkencor, struktura e maleve është përshkruar si më poshtë:
“Atje ku kontinentet janë më të trasha, si p.sh. vargmalet, korja zhytet thellë në mantel.”⁶

Në një ajet kuranor, kjo veti e maleve është vënë në dukje nga një krahasim i maleve me “kunjat”:

**“ A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme për jetë,
 ndërsa malet i bëmë si kunjat? ”**

(En-Nebe 6-7)

Me fjalë të tjera, duke u shtrirë mbi dhe nën sipërfaqen e Tokës në ato pika ku bashkohen shtresat e ndryshme, malet i mbajnë lidhur këto shtresa me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, ato fiksojnë koren e Tokës dhe parandalojnë grumbullimin e saj mbi apo ndërmjet shtresave të magmës. Shkurt, ne mund t’i krahasojmë malet me gozhdët, të cilat mbajnë dërrasat të mbërthyera së bashku.

Vetia fiksuese e maleve në literaturën shkencore është përshkruar me termin “isostazi”:

Isostazi do të thotë: ekuilibri i përgjithshëm i kores së Tokës i mbajtur nga qarkullimi i materialeve shkëmbore poshtë sipërfaqes, si rezultat i shtypjes gravitacionale.⁷

Ky rol kaq i rëndësishëm i maleve, i cili u zbulua nga gjeologjia moderne dhe nga kërkimet sizmike, është shpallur në Kuran shekuj më parë si një shembull i dijes absolute të krijimit të Zotit.

**“ Ne kemi krijuar male të patundura në tokë me qëllim që ajo
 të mos lëkundet dhe tronditet bashkë me ta... ”**

(El Enbija 31)

*Ai është shpikësi i qiejve e i tokës (pa kurrfarë modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, Ai vetëm i thotë: "Bëhu!", e ajo menjëherë bëhet.
(El-Bekare 117)*



LËVIZJA E MALEVE

Në një ajet tjetër, na bëhet e ditur se malet nuk janë të palëvizshëm, ashtu siç mund të na duket, por ato janë në lëvizje të vazhdueshme.

” **Kur i sheh malet, mendon se ata janë të palëvizshëm,**

por ata lëvizin si retë...”

(En-Neml 88)

Kjo lëvizje e maleve ndodh si pasojë e lëvizjes së kores së Tokës, mbi të cilën ato janë vendosur. Korja e Tokës ‘noton’ mbi shtresën e mantelit, e cila është më e dendur. Ishte fillimi i shekullit XX kur, për herë të parë në histori, një shkencëtar gjerman me emrin Alfred Wegener deklaroi se kontinentet kanë qenë të bashkuara në kohën e krijimit të tokës, por më pas u zhvendosën në drejtime të ndryshme dhe u ndanë, duke u larguar shumë larg njëri-tjetrit.

Gjeologët kuptuan se Wegener kishte të drejtë vetëm në vitin 1980, pra pesëdhjetë vjet pas vdekjes së tij. Sipas fjalës së Wegener në një artikull të publikuar në vitin 1915, blloqet masive të tokës u bashkuan së bashku rreth 500 milionë vjet më parë, duke formuar Pangaeon, e cila gjendej në Polin e Jugut.

Afërsisht 180 milionë vjet më parë, *Pangaea* u nda në dy pjesë, të cilat u zhvendosën në drejtime të ndryshme. Një prej këtyre kontinenteve gjigande ishte *Gondwana*, e cila përfshinte Afrikën, Australinë, Antarktidën dhe Indinë. E dyta ishte *Laurasia*, e cila përfshinte Evropën, Amerikën e Veriut dhe Azinë përveç Indisë. Njëqind e pesëdhjetë milionë vjet pas kësaj ndarjeje, *Gondwana* dhe *Laurasia* u ndanë në pjesë më të vogla.

Këto kontinente, të cilat u shfaqën pas ndarjes së Pangaeonit, janë spostuar mbi sipërfaqen e Tokës disa centimetra çdo vit, duke shkaktuar ndryshime në përqindjen e tokës dhe detit.

Kjo lëvizje u zbulua si rezultat i kërkimeve gjeologjike të kryera në fillim të shekullit XX. Lëvizja e kores së Tokës është shpjeguar nga shkencëtarët si më poshtë:

Lëvizja kontinentale



200 milionë
vjet më parë



135 milionë
vjet më parë



65 milionë vjet
më parë



Sot

Fotot në të majtë tregojnë pozicionin e kontinenteve në të kaluarën. Nëse lëvizja e kontinenteve do të vazhdojë në të njëjtën mënyrë, miliona vite më pas, ato do të jenë në pozicionin e treguar në foton në të djathtë.

Hemisfera
perëndimore
50 milionë vjet
më vonë



Hemisfera lindore
50 milionë vjet më vonë

“Korja dhe pjesa e sipërme e mantelit, me një trashësi 100 km, janë të ndara në segmente të quajtura shtresa. Gjenden gjashtë shtresa të mëdha dhe disa shtresa të vogla. Sipas teorisë të quajtur “tektonika e shtresave”, këto shtresa lëvizin në Tokë, duke mbajtur me vete “dyshemenë” e kontinenteve dhe oqeaneve. Lëvizja e kontinenteve është llogaritur të jetë 1-5 cm në vit. Gjatë kohës që shtresat vazhdojnë të lëvizin, ato realizojnë një ndryshim të vogël në gjeografinë e Tokës. Për shembull, çdo vit Oqeani Atlantik bëhet pak më i gjerë.”⁸

Në Kuran është përmendur “lëvizja e maleve”. Sot, shkencëtarët bashkëkohorë për këtë lëvizje përdorin termin “lëvizja kontinentale.”⁹

Është e padiskutueshme që kjo është një prej mrekullive të Kuranit, pasi ky argument shkencor u zbulua vetëm kohët e fundit nga shkencëtarët.

MREKULLIA E HEKURIT

Hekuri është një nga elementet e përmendura në Kuran. Në suren El Hadid, d.m.th. në suren e Hekurit thuhet:

**“ Ne e kemi zbritur hekurin, në të cilin ka forcë të
madhe dhe dobi për njerëzit...”**

(El Hadid 25)

Fjala “zbritëm poshtë” e përdorur veçanërisht për hekurin në këtë ajet, mund të mendohet se ka një kuptim metaforik që do të thotë se hekuri është dhuruar për të mirën e njerëzimit. Por nëse ne do të merrim në konsideratë kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, e cila është “i zbritur fizikisht nga qielli”, do të kuptojmë se në këtë ajet gjendet një mrekulli shkencore mjaft domethënëse.

Në sajë të kërkimeve astronomike është zbuluar se hekuri i gjendur në rruzullin tokësor ka ardhur prej yjeve gjigande të hapësirës.¹⁰

Metalet e rënda në univers janë krijuar në bërthamën e yjeve të mëdha. Gjithësesi, Sistemi ynë Diellor nuk zotëron një strukturë të përshtatshme që të prodhojë vetë hekur. Hekuri mund të prodhohet në yje shumë më të mëdhenj se Dielli, te të cilët temperatura arrin disa qindra miliona gradë. Kur sasia e hekurit në një yll tejkalon një nivel të caktuar, ylli nuk mund ta mbajë atë më gjatë dhe si rezultat ai shpërthen në një shpërthim të quajtur “nova” ose “supernova”. Si rezultat i këtij shpërthimi, meteorët që përmbajnë hekur shpërndahen nëpër univers dhe lëvizin nëpër hapësirë, derisa të tërhiqen prej forcës gravitacionale të ndonjë trupi qiellor.

E gjithë kjo na bën të qartë se hekuri nuk është formuar në Tokë, por është mbartur nëpërmjet meteorëve pas shpërthimit të yjeve në hapësirë, pra, ai **“ka zbritur në tokë”** në të njëjtën mënyrë siç është shpallur në ajetin kuranor. Është e qartë se ky fakt shkencor nuk njihet shkencërisht në shekullin VII, në kohën e shpalljes së Kuranit.

Copë hekuri



KRIJIMI NË ÇIFT

“Larg të metave është Ai që krijoi të gjitha çiftet prej bimëve që mbin toka, prej vetë njerëzve dhe prej shumë gjërave që ata nuk i dinë.”

(Ja Sin 36)

Megjithëse koncepti i fjalës "çift" ose "dy" përdoret kryesisht për mashkullin dhe femrën, shpallja "prej shumë gjërave që ata nuk i dinë" ka kuptim më të gjerë. Një prej këtyre kuptimeve është zbuluar në kohën tonë. Shkencëtarit britanik Paul Dirac, i cili propozoi se materia është e krijuar në çift, iu dha çmimi Nobël i fizikës në vitin 1933. Ky zbulim i quajtur "parité", pohon se materia është në çift me të kundërtën e saj: anti-materien. Anti-materia mbart vetitë e kundërta të materies. Për shembull, në kundërshtim me materien, anti-materia ka elektrone të ngarkuara pozitivisht dhe protone të ngarkuara negativisht. Ky fakt shtjellohet kështu nga një burim shkencor:

*"... çdo grimcë ka antigrimcën e vet me ngarkesë të kundërt...
...dhe kjo lidhje e papërcaktuar na tregon se krijimi i çifteve dhe asgjësimi i tyre ndodh në zbrazëti në çdo kohë dhe në çdo vend."*¹¹



Paul Dirac

RELATIVITETI I KOHËS

Në ditët tona, relativiteti i kohës është një argument shkencor i vërtetuar. Ky argument u zbulua nga Teoria e Relativitetit e Ajnshtajnit në fillimet e shekullit XX. Më parë, njerëzit nuk e dinin se koha është një koncept relativ dhe se ajo mund të ndryshonte me ndryshimin e vendit. Por, shkencëtari i madh Albert Ajnshtajni, vërtetoi botërisht këtë fakt me Teorinë e Relativitetit. Ai tregoi se koha varet nga pesha dhe shpejtësia. Askush nuk e kishte thënë këtë gjë kaq qartë më parë, me përjashtim të Kuranit, në të cilin gjendet informacion rreth relativitetit të kohës. Lexoni disa nga ajetet që flasin për këtë temë:

“ Ata kërkojnë prej teje që t'ua shpejtosh dënimin, por Zoti nuk e thyen premtimin e Vet, sepse një ditë të Zoti yt është sa një mijë vjet që llogaritni ju. ”

(El Haxh 47)

“ Ai e rregullon çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështje) ngrihet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa një mijë vjet. ”

(Es-Sexhde 5)



Koha është një koncept i varur tërësisht nga ai që e percepton atë. Nëse një periudhë kohe e caktuar për një person është e gjatë, e njëjta periudhë mund të duket e shkurtër për një tjetër. Me qëllim që të kuptojmë se kush ka të drejtë, ne kemi nevojë për mjete të tilla si orët dhe kalendarët. Pa to është e pamundur të llogaritet koha me saktësi.

**“ Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) në një ditë
që zgjat pesëdhjetë mijë vjet. ”**

(El Me'arixh 4)

Në disa ajete tregohet se njerëzit e perceptojnë kohën në mënyrë të ndryshme.

Në këtë mënyrë, disa njerëz mund ta konsiderojnë si shumë të gjatë një periudhë shumë të shkurtër dhe anasjelltas. Dialogu i zhvilluar ndërmjet njerëzve Ditën e Gjykimit është një shembull mjaft i mirë për këtë:

“ Zoti do t'u thotë: 'Sa vite keni jetuar në Tokë?' Ata do të thonë: 'Ne kemi ndenjur vetëm një ditë ose një pjesë të saj. Pyet ata që janë në gjendje të numërojnë.' ” (Mu'minun 112-113)

Përmendja e relativitetit të kohës në Kuran, i cili filloi të shpallej rreth vitit 610, është një argument tjetër që vërteton burimin hyjnor të këtij libri të shenjtë.



SASIA E SHIUT

Një prej shumë informacioneve të dhëna në Kuran rreth formimit të shiut është fakti se ai zbret në Tokë në një masë të caktuar. Kjo është përmendur në suren Ez-Zuhruf si më poshtë:

” Ai lëshon nga qielli shiun me masë të caktuar.


**Me të Ne i japim jetë një vendi të vdekur. Ja, kështu edhe
ju do të ringjalleni nga varret.”**

(Ez-Zuhruf 11)

Fakti i zbritjes së kësaj sasive shiu të matur dhe të përcaktuar është konfirmuar prej kërkimeve të kohëve të fundit. Është llogaritur se në një sekondë avullojnë afërsisht 16 milionë tonë ujë nga Toka. Kjo shifër arrin në 513 trilionë tonë ujë në vit. Kjo sasi është e barabartë me sasinë e shiut që bie në Tokë gjatë një viti. Kjo lë të kuptosh se uji qarkullon brenda një cikli të ekuilibruar “me masë të caktuar”. Jeta në Tokë varet nga ky qarkullim i ujit. Sikur njerëzit të shfrytëzonin të gjithë potencialin teknologjik që disponojnë, nuk do të mund ta realizonin dot këtë qarkullim në mënyrë artificiale.

Madje edhe një devijim i vogël i këtij ekuilibri, shumë shpejt do të sillte një çekuilibrim të madh ekologjik dhe për rrjedhojë, fundin e jetës në Tokë. Por kjo nuk ndodh asnjëherë dhe shiu vazhdon të bjerë çdo vit pikërisht në të njëjtën sasi, ashtu siç është shpallur në Kuran.





Çdo vit, sasia e ujit që avullon nga Toka dhe sasia e ujit që bie në formë shiu është "konstante": 513 trilionë tonë. Kjo sasi konstante është e shpallur në Kuran në ajetin: "Ai lëshon shiun nga qielli me masë të caktuar". Pandryshueshmëria e kësaj sasive është mjaft e rëndësishme për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe jetës.



FORMIMI I SHIUT

Formimi i shiut mbeti një mister për një kohë të gjatë. Vetëm pas shpikjes së mjeteve të parashikimit të motit u bë e mundur të zbuloheshin tre fazat e formimit të shiut. Së pari, avujt e ujit ngrihen lart në qiell me anë të erës, më pas formohen retë dhe në fund shfaqen pikat e shiut.

Informacioni i dhënë në Kuran për shiun përputhet saktësisht me këtë proces. Në një ajet kuranor, ky informacion është përshkruar në këtë mënyrë:

“Zoti është Ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë.

Ai i shtrin retë në qiell ashtu siç dëshiron dhe i bën të ndara në pjesë, pastaj përmes tyre sheh se si bie shiu...”

(Err-Rrum 48)

Tani, le të shohim më hollësisht këto tre faza të përshkruara në ajetin kuranor.

FAZA E PARË: “Zoti është Ai që i dërgon erërat...”


Flluska ajri të panumërta, të cilat formohen nga shkumëzimi i ujit të oqeanëve, plasin vazhdimisht dhe shkaktojnë veçimin e disa grimcave të ujit, të cilat ngrihen lart në qiell. Këto grimca të pasura me kripë (të cilat quhen aerosole) transportohen nga erërat dhe ngrihen në atmosferë. Ato funksionojnë si kolektorë uji dhe formojnë pika reje, duke i mbledhur rreth vetes avujt e ujit që ngrihen prej detit.

FAZA E DYTË: “... (erërat) lëvizin retë. Ai i shtrin retë në qiell ashtu siç dëshiron dhe i bën të ndara në pjesë ...”

Retë formohen nga avujt e ujit, të cilët kondensohen rreth kristaleve të kripës apo grimcave të pluhurit që gjenden në ajër. Meqë pikat e ujit në këto re janë mjaft të vogla (me diametër 0.01 dhe 0.02 mm), retë “qëndrojnë pezull” në ajër dhe përhapen në qiell. Në këtë mënyrë, qielli mbushet plot me re.

FAZA E TRETË: “...dhe përmes tyre sheh se si bie shiu.”

Grimcat e ujit, të cilat rrethojnë kristalet e kripës dhe grimcat e pluhurit, zmadhohen dhe formojnë pikat e shiut, të cilat bëhen më të rënda se ajri,



Ilustrimi i mësipërm tregon pikat e ujit që shpëputen në ajër. Kjo është faza e parë e formimit të shiut. Më pas, pikat e shiut në retë e sapoformuara do të qëndrojnë pezull në ajër dhe pastaj do të kondensohen për të formuar shiun. Të gjitha këto faza janë përshkruar në Kuran.

ndaj dhe shpëputen nga retë, duke filluar të bijnë në tokë në formë shiu.

Siç shihet, çdo fazë e formimit të shiut është shpallur në ajetet e Kuranit. Për më tepër, këto faza janë shpjeguar ekzaktësisht sipas radhës së duhur. Si shumë fenomene të tjera, edhe ky fenomen shpjegohet saktësisht në Kuran shumë shekuj më parë se të njihet nga njerëzimi.

Në një ajet tjetër është dhënë informacioni i mëposhtëm rreth formimit të shiut:

**“ A nuk e ke parë se si i drejton Zoti retë,
pastaj i bashkon, pastaj i grumbullon njëra mbi tjetrën dhe
atëherë ti shikon shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon nga lart
breshër prej reve të mëdha si malet. Me breshrin Ai godet
kë të dojë dhe e largon nga kush të dojë. Shkëlqimi i
vetëtimës së tij (breshrit) gati ta merr shikimin.”**

(En-Nur: 43)

Gjatë studimit të llojeve të reve, shkencëtarët u gjendën përpara një sërë

rezultatesh të papritura mbi formimin e reve të shiut. Retë e shiut krijohen dhe formohen në bazë të një sistemi fazash të përcaktuara mirë. Le të marrim për shembull renë Kumulonimbus, e cila është një prej reve të shiut. Formimi i kësaj reje kalon në tre faza:


Faza e parë: Retë shtyhen nga era: Retë Kumulonimbus fillojnë të formohen, kur era shtyn copa të vogla reje në një zonë ku ato bashkohen.

Faza e dytë: Bashkimi: Pas kësaj, retë bashkohen duke formuar një re më të madhe.¹²


Faza e tretë: Grumbullimi mbi njëra-tjetrën: Kur retë e vogla bashkohen bashkë, rriten lëvizjet nga poshtë-lart brenda resë së madhe, të cilat në qendër janë më të forta se në pjesët anësore të resë, sepse pjesët e jashtme të resë e mbrojnë qendrën prej efekteve ftohëse. Këto lëvizje bëjnë që trupi i resë të rritet vertikalisht. Duke u rritur vertikalisht, reja shtrihet në zona më të ftohta të atmosferës, ku pikat e ujit dhe breshrit formohen dhe fillojnë të rrisin përmasat e tyre. Kur këto pika uji e breshri bëhen tepër të rënda dhe lëvizja nga poshtë-lart nuk mund t'i mbajë pezull, atëherë ato fillojnë të bien nga reja në formë shiu, breshri etj.¹³

Detajet e formimit, të strukturës dhe funksionimit të reve janë zbuluar





(A) Pjesë të vogla të reze të izoluar (retë kumulus)
 (B) Kur retë e vogla bashkohen me njëra-tjetrën, rrymat e ajrit brenda resë së madhe rriten dhe kështu reja zmadhohet, duke marrë formën e mullarit.



Këto lëvizje bëjnë që trupi i resë të rritet vertikalisht, duke marrë formën e mullarit. Duke u rritur vertikalisht, reja shtrihet në zona më të ftohta të atmosferës, ku pikat e ujit dhe breshrit formohen dhe fillojnë të rrisin përmasat e tyre. Kur këto pika uji e breshri bëhen tepër të rënda dhe lëvizja nga poshtë-lart nuk mund t'i mbajë pezull, atëherë ato fillojnë të bien nga reja në formë shiu, breshri etj. Ky argument shkencor është shpallur 14 shekuj më parë prej Zotit, në ajetin 43 të Sures En-Nur, në këtë mënyrë:
 "A nuk e ke parë se si i drejton Zoti retë, pastaj i bashkon, pastaj i grumbullon njëra mbi tjetrën dhe atëherë ti shikon shiun se si rrjedh prej tyre." (En-nur: 43)

nga meteorologët nëpërmjet përdorimit të mjeteve të sofistikuara si ballonat, aeroplanët, satelitët, kompjuterat etj. Është e qartë se në këtë ajet Zoti na jep një informacion që nuk kishte si të njihej 1400 vjet më parë..

Retë e vogla (retë Kumulus) lëvizin dhe bashkohen nëpërmjet erës, ashtu siç thuhet në Kuran:
 "A nuk e ke parë se si i drejton Zoti retë, pastaj i bashkon, pastaj i grumbullon njëra mbi tjetrën."



ERËRAT FEKONDUERE

Në një ajet tjetër në Kuran, është përmendur karakteristika “fekonduese” e erës, si rezultat i së cilës formohet shiu.

“ Ne i dërgojmë erërat “fekonduese”, pastaj lëshojmë shi nga qielli që t’ju japim për të pirë...”

(El Hixhr 22)

Në këtë ajet na bëhet e qartë se faza e parë e formimit të shiut është era. Deri në fillim të shekullit XX, e vetmja lidhje e njohur ndërmjet erës dhe shiut ishte se “era lëviz retë”. Por ishin kërkimet meteorologjike të kohës së sotme që zbuluan dhe vërtetuan rolin “fekondues” të erës në formimin e shiut. Vetia fekonduese e erës funksionon në këtë mënyrë:

Në sipërfaqen e oqeaneve dhe deteve formohen flluska ajri si pasojë e shkumëzimit të ujit. Në momentin që këto flluska pëlçasin, me mijëra grimca të vogla, me diametër një të qindtën e milimetrit, ngrihen lart në ajër. Këto grimca të njohura me emrin “aerosole”, përzihen me pluhurin e tokës të mbartur nga era dhe ngrihen në shtresat më të larta të atmosferës, ku bien në kontakt me avujt e ujit. Avujt e ujit kondensohen rreth këtyre grimcave, duke u kthyer në pika të vogla uji, të cilat bashkohen me njëra-tjetrën, duke formuar retë dhe pastaj bien në Tokë në formë shiu.

Siç shihet, erërat “fekondojnë” avujt e ujit me grimcat që ato mbajnë nga deti dhe për rrjedhojë, formojnë retë e shiut.

Nëse erërat nuk do ta kishin këtë veti, pikat e ujit në shtresat e larta të atmosferës nuk do të formoheshin kurrë dhe ne nuk do të kishim shi.

Pra, roli vendimtar i erës në formimin e shiut është shpallur shekuj më parë në një ajet të Kuranit, në një kohë kur njerëzit dinin shumë pak rreth fenomeneve natyrore...



Fotografia lart na tregon fazat e formimit të një dallge. Era fryn mbi sipërfaqen e ujit dhe i bën grimcat e tij të lëvizin në një lëvizje rrethore, e cila formon dallgët. Flluskat e formuara nga dallgët përhapen në ajër. Kjo është faza e parë e formimit të shiut. Ky fakt është shpallur në ajetin “Ne i dërgojmë erërat “fekonduese”, pastaj lëshojmë shi nga qielli...”



DETET NUK PËRZIHEN ME NJËRI-TJETRIN

Një nga veçoritë karakteristike të deteve është shpallur në një prej ajeteve të Kuranit, si më poshtë:

” Ai i bëri dy detet të bashkohen me njëri-tjetrin. Ndërmjet tyre ka një pengesë që nuk i lejon të përzihen.”

(Err-Rrahman 19-20)

Kjo karakteristikë e deteve që rrinë ngjitur me njëri-tjetrin, pa u përzier mes tyre, është zbuluar jo shumë kohë më parë nga studiuesit e oqeaneve. Për shkak të forcës fizike të quajtur “tensioni sipërfaqësor”, ujërat e deteve fqinj nuk përzihen. I shkaktuar nga diferenca e dendësisë së ujërave, tensioni sipërfaqësor i ndalon detet të përzihen, sikur ndërmjet tyre të ekzistonte me të vërtetë një pengesë.¹⁴

Aspekti interesant i këtij fenomeni është se ai është shpallur në Kuran në kohën kur njerëzit nuk kishin njohuri mbi fizikën, tensionin sipërfaqësor, apo oqeanografinë.



Në Detin Mesdhe dhe në Oqeanin Atlantik gjenden dallgë të mëdha, korrente të forta dhe rryma. Uji i Detit Mesdhe hyn në Atlantik nëpërmjet Gjibraltarit, por temperatura, kripësia dhe dendësia e secilit prej tyre nuk ndryshojnë, për shkak të kufijve që i mbajnë të ndarë nga njëri-tjetri.

Foto e Gjibraltarit me satelit



ERRËSIRAT E DETEVE DHE VALËT E BRENDSHME

“ (Gjendja e jobesimtarëve është) si errësira në një det të thellë e të madh. Ai është i mbuluar me valë, mbi të cilat gjenden valë të tjera e mbi to gjenden re të dendura. Errësirë mbi errësirë. Nëse dikush do të zgjaste dorën, nuk do të ishte në gjendje ta shihte atë... ”

(En-Nur 40)

Gjendja e përgjithshme në thellësitë e deteve dhe oqeanëve është përshkruar në librin me titull “Oqeanet”:

“Errësira në dete dhe oqeanë fillon në thellësinë 200 metra e poshtë. Në këtë thellësi zakonisht nuk ka dritë. Nën thellësinë 1000 metra është errësirë e plotë.”¹⁵

Sot, ne zotërojmë njohuri mbi strukturën e përgjithshme të detit, mbi karakteristikat e gjallesave në të, mbi kripësinë e tij, ashtu siç njohim dhe sasinë e tij të ujit, sipërfaqen dhe thellësinë e tij. Ishin nëndetëset dhe pajisjet e sofistikuar, të zhvilluara prej teknologjisë bashkëkohore, të cilat u krijuan mundësinë shkencëtarëve të sigurojnë këtë informacion.

Qeniet njerëzore nuk janë të afta të zhyten më thellë se 40 metra nën ujë pa ndihmën e pajimeve speciale. Ata nuk mund të mbijetojnë në pjesët e errëta të oqeanëve si p.sh. në thellësinë 200 metra. Për këtë arsye, vetëm kohët e fundit shkencëtarët arritën të zbulojnë këto informacione të hollësishme të informacionit rreth deteve.

Por ky fakt është përmendur në suren En-nur pikërisht në pjesën **“errësira në një det të thellë e të madh”**. Kjo është sigurisht një prej mrekullive të Kuranit, sepse është thënë në një kohë kur njerëzit nuk zotëronin pajisjet e nevojshme për t’u zhytur në thellësitë e oqeanëve.

Por nuk është vetëm kjo; shpallja në ajetin e dyzetë të sures En-Nur na tërheq vëmendjen te një tjetër mrekulli shkencore e Kuranit **“... si errësira në një det të thellë e të madh. Ai është i mbuluar me valë, mbi të cilat gjenden valë të tjera e mbi to gjenden re të dendura...”**.


Ky ajet na jep mundësinë të kuptojmë, se në ujërat në thellësi të



Matjet e bëra në ditët e sotme nxorën në dritë se 3 deri në 30 përqind e rrezeve të diellit përthihen në sipërfaqen e detit. Gati të shtatë ngjyrat e dritës përthithen njëra pas tjetrës në 200 metrat e para, përveç dritës blu (fotoja në të majtë). Nën 1000 metra nuk ka më dritë (fotoja lart). Ky argument shkencor ndodhet që prej 1400 vjetësh në ajetin e dyzetë të sures En-Nur.

oqeaneve gjenden valë, mbi të cilat gjenden valë të tjera. Merret lehtë me mend se valët e dyta janë valët sipërfaqësore, sepse pas tyre përmenden retë. Po valët e para ç'janë?

Kohët e fundit shkencëtarët zbuluan se ekzistojnë valë të brendshme, të cilat "hasen ndërmjet shtresave me dendësi të ndryshme". Këto valë të brendshme mbulojnë ujrat e thellë të deteve dhe oqeaneve, sepse ujërat në thellësi kanë dendësi më të lartë se ujërat sipër tyre. Valët e brendshme lëvizin në mënyrë të ngjashme me valët sipërfaqësore, madje ato përthihen ashtu siç përthihen



Fotoja në të majtë paraqet valët e brendshme si një ndarje ndërmjet dy shtresave të ujit me dendësi të ndryshme. Shtresa e poshtme është më e dendur se ajo që gjendet lart saj. Ky argument shkencor, i cili është shpallur 14 shekuj më parë në ajetin e dyzetë të sures En-Nur, u zbulua prej shkencëtarëve vetëm kohët e fundit.

dhe valët sipërfaqësore. Valët e brendshme nuk mund të shihen nga syri i njeriut, por mund të diktohen me anë të studimit të ndryshimit të temperaturës ose kripësisë në një vend të caktuar.¹⁶

Shpallja në Kuran ecën paralelisht me shpjegimin e mësipërm. Pa mjetet e duhura, njeriu mund të shohë vetëm valët mbi sipërfaqen e detit, ndaj është e pamundur që dikush të ketë dijeni rreth valëve të brendshme në thellësi të detit. Por, ndërkohë, në suren En-Nur, Zoti na flet për një lloj tjetër valësh, të cilat gjenden në thellësi të oqeanëve. Natyrisht që ky fakt, të cilin shkencëtarët e zbuluan shumë vonë, na tregon edhe një herë se Kurani është fjala e Zotit.



ZONA E TRURIT QË KONTROLLON LËVIZJEN

” Jo, Jo! Nëse ai nuk ndalon, Ne do ta kapim prej ballukeve.

Balluke gënjeshtare dhe mëkatare.”

(El Alek 15-16)

Fraza **“balluke gënjeshtare dhe mëkatare”** në ajetin e mësipërm është mjaft interesante. Përse i quan Kurani flokët e pjesës së përparme të kokës gënjeshtare dhe mëkatare? A nuk është vetë njeriu gënjeshtar dhe mëkatar? Cila është lidhja që ekziston midis gënjeshtres e mëkatit nga njëra anë dhe ballukeve (apo flokëve të pjesës së përparme të kokës) nga ana tjetër? Kërkimet e kryera kohët e fundit zbuluan se fusha ballore, e cila është përgjegjëse për drejtimin e të gjitha funksioneve specifike të trurit, ndodhet në pjesën e përparme të tij. Vetëm në 60 vitet e fundit, shkencëtarët e zbuluan funksionin e kësaj zone, gjë të cilën Kurani e ka përmendur që 1400 vjet më parë. Nëse shohim brenda kafkës në pjesën e përparme të kokës, ne do të gjejmë fushën ballore të trurit. Në një libër me titull *Bazat e Anatomisë dhe Psikologjisë*, në të cilin përfshihen kërkimet më të fundit mbi efektet e kësaj fushe në tru, thuhet:

Motivimi dhe parashikimi për të planifikuar dhe për të filluar lëvizjet ndodh në pjesën e përparme të lobit ballor, pikërisht në fushën ballore. Kjo është një zonë ku ndodh procesi informues...¹⁷

Libri gjithashtu thotë:

Në lidhje me përfshirjen e saj në motivim, fusha ballore mendohet të jetë gjithashtu qendra funksionale e agresionit...¹⁸

Kështu, kjo zonë e trurit është përgjegjëse për planifikimin, motivimin dhe kryerjen e punëve të mira e të këqija, ashtu siç është përgjegjëse për thënien e gënjeshtreve dhe të vërtetave.

Është më se e qartë se shpallja **“balluke gënjeshtare dhe mëkatare”** përputhet tërësisht me shpjegimin e mësipërm. Ky fakt, të cilin shkencëtarët e zbuluan në 60 vitet e fundit, është shpallur nga Zoti në Kuran shumë shekuj më parë.



KRIJIMI I NJERIUT

Në shumë ajete, njerëzve u bëhet thirrje që të përqëndrojnë vëmendjen në krijimin e tyre. Shumë shpesh atyre u kujtohet ardhja në jetë e njeriut, fazat në të cilat ka kaluar krijimi i tij dhe se çfarë është ai në thelb:

**“ Ne ju kemi krijuar juve; përse pra nuk e pranoni të vërtetën?!
A keni menduar ndonjëherë për farën (spermën) që nxirrni?
Mos vallë ju e krijoni atë, apo jemi Ne krijuesit e saj? ”**

(El Uakia 57-59)

Krijimi i njeriut, bashkë me mrekullitë e shumta që përmban, është theksuar në mjaft ajete të tjera. Disa pjesë të informacionit të përmendur në disa ajete kuranore janë kaq të hollësishme saqë është e pamundur që një njeri, i cili ka jetuar në shekullin e 7^{-të} të kishte njohuri për to. Disa prej këtyre pikave janë si më poshtë:

1- Njeriu nuk është krijuar nga e tërë fara, por nga një pjesë mjaft e vogël e saj.

2- Është mashkulli ai që luan rol në përcaktimin e gjinisë së fëmijës dhe jo femra.

3- Embrioni njerëzor ngjitet në mitrën e nënës si një shushunjë.

4- Embrioni zhvillohet brenda tri errësirave (shtresave) në mitër.

Në kohën e shpalljes së Kuranit, njerëzit e dinin me siguri që faktori bazë në lindjen e njeriut ishte fara e mashkullit. Po ashtu, fakti që foshnja lind mbas një periudhe prej nëntë muajsh kuptohej nga të gjithë dhe s’kishte nevojë për vëzhgime të mëtejshme. Ndërsa informacioni i përmendur në pikat që cituam më lart ishte i paarritshëm dhe i pakonceptueshëm nga niveli i njohurive që zotëronin njerëzit e asaj kohe. Këto të dhëna u vërtetuan në mënyrë shkencore vetëm në shekullin XX.

Tani le t’i studiojmë këto pika një nga një.

Një pikë e farës

Gjatë marrëdhënieve seksuale, nga organi seksual i mashkullit dalin njëherësh rreth 250 milionë spermatozoidë, të cilët nisin një udhëtim të mundimshëm në trupin e femrës, derisa arrijnë te veza. Nga 250 milionë spermatozoidë vetëm një mijë prej tyre ia dalin të arrijnë në destinacionin e duhur. Në fund të kësaj "gare", veza lejon vetëm një qelizë spermatozoide që të depërtojë brenda saj. Ky është thelbi i njeriut, i cili nuk është krijuar nga e tërë sperma, por nga një pjesë shumë e vogël e saj. Në Kuran thuhet:

” A mos mendon njeriu se do të lihet pa u ngarkuar me përgjegjësi.

A nuk ka qenë ai dikur një pikë e farës që derdhet? ”

(El Kijame 36-37)

Siç shihet, Kurani na informon se njeriu nuk është krijuar nga e gjithë sperma, por nga një pjesë shumë e vogël e saj. Ky fakt që theksohet në këtë shpallje është zbuluar prej shkencës bashkëkohore dhe është një dëshmi e qartë e origjinës hyjnore të saj.



Në foton në të majtë, shohim momentin e derdhjes së spermës në mitër. Nga 250 milionë spermatozoidet e lëshuara nga mashkulli, vetëm një numër shumë i vogël prej tyre e arrijnë vezën. Spermatozoidi që do të fekundojë vezën është një prej një mijë qelizave spermatozoide që arrijnë të mbijetojnë. Fakti që njeriu nuk është krijuar nga e tërë fara por nga një pjesë e vogël e saj, është shpallur në Kuran me shprehjen "një pikë e farës që derdhet".

Përzierja në farë (spermë)

Fara nuk përmban vetëm spermatozoide, por edhe një përzierje lëngjesh të ndryshme. Këto lëngje kanë funksione të ndryshme, siç është mbajtja e sheqerit, i cili është i nevojshëm për t'u dhënë energji spermatozoideve, neutralizimi i acideve gjatë hyrjes në mitër dhe krijimi i një ambjenti rrëshqitës në mënyrë që t'u lejojë lëvizje të lirë spermatozoideve. Kur përmendet fara në Kuran, ajo përshkruhet si një lëng i përzierë:

**“ Ne e krijuam njeriun prej një pike uji të përzier
me qëllim që ta sprovojmë atë...” ”**


(El Insan 2)

Një ajet tjetër, po ashtu, bën fjalë për farën si një përzierje. Në të theksohet se njeriu është krijuar nga “esenca” e kësaj përzierje:

**“ Ai e përsosi krijimin e çdo gjëje dhe filloi krijimin e
njeriut nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të shtohen prej
esencës së një lëngu të dobët.” ”**

(Es-Sexhde 7-8)

Fjala arabe “sulale” e përkthyer si “esencë”, nënkupton diçka esenciale ose pjesën më të mirë të diçkaje. Në raste të tjera ajo nënkupton “një pjesë të një tërësie”. Kjo tregon që Kurani është fjala e Atij që e njuh krijimin e njeriut në detajet më të hollësishme. Ai është Zoti, Krijuesi i njeriut.



Gjinia e foshnjes

Jo shumë kohë më parë mendohej se gjinia e foshnjes përcaktohej prej qelizave të nënës. Ose më saktë, besohej se gjinia ishte e përcaktuar nga qelizat e mashkullit dhe të femrës së bashku. Por në Kuran na është dhënë një informacion i ndryshëm, sipas të cilit të dy gjinitë janë krijuar nga "pika e farës që hidhet".

**“ Ai i krijoi të dy gjinitë, mashkullin dhe femrën,
prej pikës së farës që hidhet.”**

(En-Nexhm 46-47)


Përmendja e dy gjinive nuk është e rastësishme. Nëse Zoti do të kishte për qëllim thjesht krijimin e njeriut, atëherë në ajet do të thuhej **“Ai e krijoi njeriun... prej pikës së farës..”**. Mirëpo ajeti na informon se Zoti i krijoi të dy gjinitë prej pikës së farës...

Zhvillimi i gjenetikës dhe biologjisë molekulare ka vërtetuar shkencërisht saktësinë e këtij informacioni të dhënë në Kuran. Tani është e qartë se gjinia përcaktohet nga qelizat spermatozoide të mashkullit, ndërsa femra nuk luan asnjë rol në këtë proces.

Kromozomet janë elementet bazë në përcaktimin e gjinisë. Dy nga 46 kromozomet, të cilat përcaktojnë strukturën e njeriut, janë të njohura si kromozomet seksuale. Këto dy kromozome të mashkullit janë emërtuar "XY", ndërsa të femrës "XX", sepse forma e këtyre kromozomeve ngjason me



Në Kuran thuhet se meshkujt dhe femrat janë krijuar nga "pika e farës që derdhet". Gjithësesi, jo shumë kohë më parë, besohej se gjinia e foshnjës përcaktohej nga qelizat e nënës. Shkenca arriti ta zbulojë faktin e përmendur në Kuran vetëm në shekullin XX.



Kromozomi Y mbart karakteristikat mashkullore, ndërsa kromozomi X ato femërore. Në vezën e nënës ndodhet vetëm kromozomi X. Në farën e babait ndodhen spermatozoide që mbajnë kromozome X dhe Y. Kështu pra, gjinia e foshnjës varet nga fakti

se cili prej kromozomeve ndodhet në spermatozoidin që fekondon vezën, X^i apo Y^i . Me fjalë të tjera, ashtu siç është shpallur dhe në ajet, rolin kryesor në përcaktimin e gjinisë e luan sperma që del nga babai. Kjo njohuri, e cila nuk dihej në kohën kur u shpall Kurani, është argument i qartë për burimin hyjnor të Kuranit.

shkronjat përkatëse. Kromozomi Y mban kodin gjenetik të mashkullit, kurse kromozomi X atë të femrës.

Formimi i një qenieje njerëzore fillon me ndërthurjen e një prej këtyre kromozomeve, i cili gjendet si te çiftet e mashkullit, ashtu edhe te ato të femrës. Te femra, komponentet e qelizës seksuale, të cilat ndahen në dy pjesë gjatë ovulacionit, mbajnë kromozomet X. Qeliza seksuale e mashkullit, nga ana tjetër, prodhon dy lloje të ndryshme qelizash spermatozoide, njëra prej të cilave përmban kromozomet X, ndërsa tjetra Y. Nëse një kromozom X i femrës bashkohet me një qelizë spermatozoide, e cila përmban një kromozom X, atëherë fëmija do të jetë femër. Nëse ai bashkohet me një qelizë spermatozoide që përmban kromozomin Y, fëmija do të jetë mashkull.

Me fjalë të tjera, gjinia e foshnjës përcaktohet nga ai kromozom i mashkullit që bashkohet me vezën e femrës.

Asgjë prej këtij informacioni nuk dihej para shekullit XX, gjatë të cilit u zbuluan gjenet. Në të vërtetë, më parë besohej se femrat ishte përgjegjëse në lidhje me gjininë e foshnjës. Kjo është edhe arsyeja pse gratë fajësoheshin kur lindnin vajza.

Trembëdhjetë shekuj para zbulimit të gjeneve, në Kuran shpallet lajmi i cili hodhi poshtë këtë besim të kotë, duke bërë të qartë se gjinia e njeriut nuk e ka pikënisjen nga femra, por te sperma e mashkullit.

Ngjitja e lëngut të mpiksur në mitër

Nëse do të vazhdonim t'i studionim më tej argumentet e shpallura në Kuran rreth formimit të embrionit të njeriut, do të hasnim në disa mrekulli shkencore të tjera shumë të rëndësishme.

Kur qeliza spermatozoide bashkohet me vezën e femrës, fillon të formohet qeliza bazë e embrionit. Qeliza e vetme, e cila njihet në biologji me emrin "zigotë", fillon menjëherë të riprodhohet nëpërmjet ndarjes dhe më pas shndërrohet në një "copë mishi" të quajtur embrion. Sigurisht që kjo mund të shihet nga njerëzit vetëm se me ndihmën e mikroskopit.

Sidoqoftë, gjatë periudhës së zhvillimit, embrioni nuk qëndron në zbrazëtirë. Ai ngjitet në mitër siç ngjiten rrënjët e një bime, të cilat fiksohen fort në tokë nëpërmjet lozeve të tyre. Nëpërmjet kësaj lidhjeje, embrioni arrin të marrë prej trupit të nënës substancat e nevojshme të jetës.¹⁹

Në këtë pikë, një mrekulli mjaft domethënëse është shpallur në Kuran. Duke iu referuar zhvillimit të embrionit në barkun e nënës, Zoti përdor në Kuran fjalën "alek", e cila është dhe faza e parë e përshkrimit të zhvillimit të tij.

“ Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi çdo gjë.

Krijoi njeriun prej alekut (në mitrën e nënës).

Lexo, se Zoti yt është më bujari! ”

(El-Alek 1-3)

Nga ana gjuhësore, fjala alek ka kuptimin e "diçkaje të varur apo të ngjitur në diçka tjetër". E njëjta fjalë përdoret për të përshkruar shushunjat që ngjiten ne trup për të thithur gjakun.

Sigurisht, përdorimi i kësaj fjale për të përshkruar në mënyrë mjaft të përshtatshme zhvillimin e embrionit në barkun e nënës, vërteton edhe një herë se Kurani është shpallje nga Zoti, Zoti i gjithçkaje.



Në fazën e parë të zhvillimit, foshnja në barkun e nënës është në formën e zigotës, e cila ngjitet në mitër me qëllim që të ushqehet prej gjakut të nënës. Në foton lart duket zigota, e cila ngjason me një copë mishi. Ky fakt, i cili u zbulua nga embriologjia bashkëkohore, është një mrekulli e shpallur në Kuran 14 shekuj më parë me anë të fjalës "alek", që nënkupton "diçka që ngjitet dhe varet në një vend" dhe përdoret për të përshkruar shushunjën, e cila ngjitet në trup për të thithur gjak.

Mbështjellja e muskujve rreth kockave

Një nga ajetet që përshkruan fazat e zhvillimit të embrionit të njeriut pohon faktin se në barkun e nënës në fillim zhvillohen kockat dhe më pas muskujt:

**” ... Pastaj e shndërruam pikën në alek, pastaj
alekun e shndërruam në copë mishi, pastaj këtë copë mishi e
shndërruam në eshtra, pastaj eshtrave u veshëm mishin, pastaj e
bëmë njeriun krijesë tjetër (me shpirt).
I lartë është Zoti, Krijuesi më i mirë.”**
(El-mu’minun 12-14)

Deri pak kohë më parë, embriologët ishin të mendimit se kockat dhe muskujt në embrion zhvillohen në të njëjtën kohë. Për këtë arsye, për një kohë të gjatë, disa njerëz pretendonin se këto ajete ishin në kundërshtim me shkencën. Por kërkimet e fundit mikroskopike, të ndihmuara nga avantazhi i teknologjisë moderne, zbuluan se shpallja në Kuran është e saktë.

Vëzhgimet në nivele mikroskopike treguan se zhvillimi i embrionit në barkun e nënës ndodh në përputhje të plotë me përshkrimin në Kuran. Së pari, indet kërcore të embrionit kthehen në kocka. Më pas, qelizat muskulore, të cilat formohen prej indeve përreth kockave bashkohen dhe mbështjellin kockat.

Ky proces është shpjeguar si më



Kockat e foshnjës mbasi zhvillohen krejtësisht në barkun e nënës, vishen me mish gjatë një faze të veçantë.



Shumë prej fazave të zhvillimit të fëmijës në barkun e nënës janë shpallur në Kuran. Siç thuhet edhe në ajetin e katërmbëdhjetë të sures El Mu'minin, in det kërcore të embrionit, në fillim, shndërrohen në kocka. Pastaj kockat vishen me qeliza muskulore. Zoti e përshkruan këtë zhvillim në ajetin: "... pastaj mudgan e shndërroam në eshtra, pastaj eshtrave u veshëm mishin."

poshtë në librin e mirënjohur, *Zhvillimi i njeriut*, i cili është shkruar nga një prej shkencëtarëve më të spikatur në fushën e anatomisë dhe embriologjisë.

Gjatë javës së shtatë, skeleti fillon të shpërndahet nëpër tërë embrionin dhe kockat marrin formën e tyre natyrale. Në fund të javës së shtatë dhe gjatë javës së tetë, muskujt zënë vendin e tyre rreth formave të kockës.²⁰

Pra, fazat e zhvillimit të njeriut të përshkruara në Kuran janë në përputhje të plotë me zbulimet e embriologjisë bashkëkohore.

Tri fazat e foshnjës në mitër

Në Kuran është shpallur se njeriu është krijuar në barkun e nënës në tri faza.

“
... Ai ju krijoi në barkun e nënave tuaja, fazë pas faze,
në tri errësira. Ky është Zoti, Zoti juaj,
vetëm i Tij është pushteti...”

(Ez-Zumer 6)

Siç mund të shihet nga ajeti i mësipërm, njeriu është krijuar në barkun e nënës në tri faza të veçanta. Me të vërtetë, biologjia bashkëkohore ka zbuluar se zhvillimi embrional i foshnjës realizohet në tre sektorë të veçantë në barkun e nënës. Sot, në të gjitha tekstet e embriologjisë që studiohen në fakultetet e mjekësisë, ky subjekt trajtohet si pjesë e njohurive themelore. Për shembull, në librin *Bazat e Embriologjisë së Njeriut*, i cili është një referencë e rëndësishme në fushën e embriologjisë, ky fakt përshkruhet si më poshtë: *Jeta në mitër kalon në tri faza: paraembrionike (dy javët e para plus gjysma e javës së tretë), embrionike dhe fetus (fondi i javës së tetë e deri në lindje).*²¹

Këto faza u referohen etapave të ndryshme të zhvillimit të një foshnjeje. Karakteristikat kryesore të këtyre etapave janë dhënë më poshtë:

- Faza paraembrionike

Në këtë fazë, zigota rritet nëpërmjet ndarjes së saj dhe, kur bëhet një grumbull shumëqelizor, ajo ngjitet në muret e mitrës. Ndërsa vazhdojnë të rriten, qelizat organizohen në tri shtresa.

- Faza embrionike

Kjo fazë zgjat për pesë javë e gjysmë, gjatë së cilës foshnja quhet "embrion". Në këtë fazë, sistemet dhe organet kryesore të trupit fillojnë të shfaqen prej shtresave qelizore.

- Faza fetus

Në këtë fazë, embrioni quhet "fetus". Kjo fazë fillon në javën e tetë të shtatzanisë dhe zgjat deri në momentin e lindjes. Karakteristikë dalluese e kësaj faze është se fetusit merr formën e një qenieje njerëzore me fytyrë, duar dhe këmbë. Megjithatë fillimisht është vetëm 3 cm i gjatë, që të gjitha organet



Në ajetin e gjashtë të sures Ez-Zumer tregohet qartë se njeriu është krijuar në barkun e nënës në tri faza të veçanta. Me të vërtetë, biologjia bashkëkohore ka zbuluar se zhvillimi embrional i foshnjës realizohet në tre sektorë të veçantë në barkun e nënës.



e tij janë të dallueshme. Kjo fazë zgjat për rreth 30 javë dhe zhvillimi vazhdon deri në javën e lindjes.

Informacioni mbi zhvillimin e foshnjës në barkun e nënës u bë i mundur vetëm pasi u bënë vëzhgime me mjete dhe metoda bashkëkohore. Si shumë argumente të tjera shkencore, disa pjesë të këtij informacioni janë shpallur në ajetet e Kuranit. Përmendja e këtij informacioni kaq të detajuar dhe të përpiktë, në një kohë kur njerëzit kishin njohuri të pakta mbi çështjet e embrionologjisë, është një tregues i qartë se Kurani nuk është fjala e një njeriu, por është fjala e Zotit.

QUMËSHTI I NËNËS

Qumështi i nënës është një përzierje e pakrahasueshme që shërben si burim ushqimor i shkëlqyeshëm për foshnjën e porsalindur dhe rrit rezistencën ndaj sëmundjeve. As ushqimi artificial për fëmijë i prodhuar nga teknologjia e ditëve tona nuk mund ta zëvendësojë këtë burim ushqimi të mrekullueshëm.

Çdo ditë zbulohen dobi të reja që përmban qumështi i nënës për fëmijën. Një prej argumenteve që shkenca ka zbuluar rreth qumështit të nënës është se pirja e tij gjatë dy viteve të para të jetës ka dobi mjaft të madhe.²² Në Kuran

jepet një lajm mjaft i rëndësishëm 14 shekuj më parë në lidhje me këtë fakt të zbuluar nga shkenca vetëm kohët e fundit:

**“ Nënata duhet t’i
ushqejnë foshnjat e tyre
për dy vjet me radhë... ”**
(El-Bekare 233)

**“ Ne e kemi urdhëruar
njeriun
që të sillet mirë me prindërit,
sepse nëna e vet e mbajti në
barkun e saj, me vështirësi pas
vështirësie dhe pas dy
viteve ia ndau gjirin.
Ji mirënjohës ndaj Meje dhe
ndaj dy prindërve të tu,
sepse tek Unë është
kthimi juaj. ”**
(Lukman 14)



IDENTITETI NË SHENJAT E GISHTËRINJVE

Çdo njeri, duke përfshirë edhe binjakët që mezi dallohen nga njëri-tjetri, ka shenjat e tij të veçanta të gishtërinjve. Me fjalë të tjera, identiteti i secilit është i koduar në majat e gishtërinjve të tij. Ky sistem i koduar mund të krahasohet me sistemin e kodit të vijave, i cili përdoret në ditët tona për identifikimin e prodhimeve të ndryshme, si prodhimet industriale apo ushqimore.

“ A mendon njeriu se nuk do t'i mbledhim eshtrat e tij? Po, do t'i mbledhim! Madje Ne jemi të zotë t'i krijojmë përsëri edhe majat e gishtërinjve të tij!**”** (El Kijame 3-4)



Çdo njeri, duke përfshirë edhe binjakët që mezi dallohen nga njëri-tjetri, ka shenjat e tij të veçanta të gishtërinjve. Me fjalë të tjera, identiteti i secilit është i koduar në majat e gishtërinjve të tij. Ky sistem i koduar mund të krahasohet me sistemin e kodit të vijave, i cili përdoret në ditët tona për identifikimin e prodhimeve të ndryshme, si prodhimet industriale apo ushqimore.

Theksimi i shenjave të gishtërinjve ka një domethënie mjaft të veçantë, sepse secili ka shenjën e tij unike të gishtërinjve, e cila nuk i ngjason askujt. Çdo person që jeton apo ka jetuar në këtë botë ka formën e tij unike të shenjave të gishtërinjve. Për këtë arsye, shenjat e gishtërinjve janë një provë mjaft e rëndësishme e identitetit, ndaj dhe sot përdoren pikërisht për këtë qëllim.²³

Por më e rëndësishmja është se kjo veçori e shenjave të gishtërinjve u zbulua nga fundit i shekullit të 19-të. Përpara kësaj periudhe, njerëzit i shihnin shenjat e gishtërinjve si disa rrathë të zakonshëm, pa ndonjë rëndësi apo kuptim specifik. Është Kurani ai që na flet për këtë karakteristikë dalluese të shenjave të gishtërinjve, e cila nuk u kuptua veçse në ditët tona.



**INFORMACIONI I
DHËNË NË
KURAN MBI TË
ARDHMEN**

PARATHËNIE

Një aspekt tjetër i mrekullive të Kuranit është përmendja e një sërë ngjarjesh të rëndësishme, të cilat ndodhën më vonë. Për shembull, në suren El-Fet'h, besimtarët përgëzohen me lajmin e rikthimit në Mekë, e cila më parë ishte nën sundimin e idhujtarëve:

” Zoti e vërtetoi ëndrrën e të dërguarit të Tij.

Me dëshirën dhe vullnetin e Zotit,

**ju do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar,
me flokë të rruar apo të shkurtuar, pa iu frikësuar askujt.**

Ai di atë çka ju nuk e dini dhe para saj ju dha

një fitore të afërt (çlirimi i Hajberit).”

(El Fetih 27)

I parë nga afër, ky ajet shpall një tjetër fitore, e cila do të ndodhte para fitores së Mekës. Me të vërtetë, ashtu siç është shpallur edhe në ajet, besimtarët morën Fortesën e Hajberit, e cila ishte nën kontrollin e çifutëve dhe më pas hynë në Mekë.

Shpallja e ngjarjeve të së ardhmes është vetëm një pjesë e dijes së Kuranit. Ajo është gjithashtu argument se Kurani është fjala e Zotit, i Cili ka dije të pafundme.



Jeruzalemi

Deti i
Vdekur

FITORJA E BIZANTIT

Një nga informacionet e përmendura në Kuran mbi atë që do të ndodhte në të ardhmen, gjendet në ajetet e para të sures Er-Rum, të cilat i referohen Perandorisë Bizantine apo pjesës lindore të Perandorisë Romake. Në këto ajete është shpallur se Perandoria Bizantine, pas disfatës së rëndë që kishte pësuar prej ushtrisë perse, do të triumfonte shumë shpejt.

**“ Elif, Lam, Mim. Bizantinët (romakët) u mundën,
në tokën më të ulët (afërt), por pas disfatës së tyre,
ata do të triumfojnë brenda pak viteve. ”**

(Er-Rum 1-3)



Shtrati i Detit të Vdekur, apo Liqenit të Lutit, ku bizantinët u mundën nga persët. Lart është një foto e vendit, marrë nga sateliti. Liqeni i Lutit, i cili është vendi më i ulët në tokë, gjendet 395 metra nën nivelin e detit.

Këto ajete u shpallën rreth vitit 620 e.s., gati shtatë vjet pas humbjes së thellë të ushtrisë kristiane bizantine prej ushtrisë idhujtare perse. Por në Kuran u shpall se shumë shpejt bizantinët do të triumfonin mbi rivalin e tyre. Në fakt, duke parë disfatën e rëndë të bizantinëve, dukej gati e pamundur që shteti bizantin do të mbijetonte, jo më të fitonte përsëri. Jo vetëm persët, por edhe avarët, sllavët e lombardianët përbënin një kërcënim serioz për Perandorinë Bizantine. Avarët kishin arritur deri në muret e Kostandinopojës. Perandori bizantin, Heraklius, urdhëroi që ari dhe argjendi që gjendej në kisha të shkrihej dhe me to të bëheshin para për të përballuar shpenzimet e ushtrisë. Kur këto nuk mjaftuan, edhe statujat e bronxit u shkrinë për t'u kthyer në para. Shumë guvernatorë ngritën krye kundër perandorit Heraklius, ndaj dhe perandoria gjendej në një situatë tepër

kritike. Mesopotamia, Siria, Palestina, Egjipti dhe Armenia, të cilat kohë më parë i përkisnin Perandorisë Bizantine, ishin pushtuar nga idhujtarët persë.²⁴

Me pak fjalë, të gjithë pritnin nga çasti në çast shkatërrimin e Perandorisë Bizantine. Pikërisht në ato momente u shpallën ajetet e para të sures Er-Rum, sipas të cilave bizantinët do të triumfonin pas pak vitesh. Kjo fitore dukej aq e pamundur, sa që idhujtarët e Mekës, të cilët ishin mjaft larg vendit të ngjarjes, filluan të talleshin me besimtarët e paktë. Ata besonin se fitorja e shpallur në Kuran nuk do të bëhej kurrë realitet.

Shtatë vjet pas shpalljes së ajeteve të para të sures Er-Rum, në Dhjetor të vitit 627 e.s. një betejë e përgjakshme u zhvillua ndërmjet ushtrisë bizantine dhe asaj perse në Niniveh. Ndodhi ajo që s'pritej; ushtria bizantine triumfoi mbi ushtrinë perse. Disa muaj më vonë, persianët u detyruan të bënin një marrëveshje me Perandorinë Bizantine, sipas së cilës ata detyroheshin t'i rikthenin asaj të gjitha territoret e pushtuara prej tyre. Më në fund, "fitorja e bizantinëve" e shpallur në Kuran u bë realitet.

Një tjetër mrekulli e shpallur në këto ajete është një dukuri gjeografike që nuk mund të njëhej prej askujt në atë kohë.





Lart është fotografia e Detit të Vdekur, marrë nga sateliti. Lartësia e Detit të Vdekur mund të përcaktohet vetëm me pajisje moderne. Këto matje nxorën në dritë faktin se ai vend është me të vërtetë "vendi më i ulët i Tokës".

Në ajetin e tretë të sures Er-Rum tregohet se romakët pësuan disfatë në vendin më të ulët në Tokë. Fjala "Edna el-erd" në arabisht është interpretuar në mjaft përkthime si "vendi më i afërt". Por ky nuk është kuptimi i drejtpërdrejtë i shpalljes në origjinal, por është më tepër një kuptim figurativ i saj. Fjala "Edna" në arabisht vjen nga fjala "denij" që nënkupton "i ulët", ndërsa "edna" do të thotë "më i ulti", ndërsa "Erd" do të thotë "tokë". Kështu që shprehja "Edna el Erd" do të thotë "vendi më i ulët në Tokë".

Fakti më interesant është se etapat më të rëndësishme të luftës së zhvilluar ndërmjet bizantinëve dhe persëve, në të cilën bizantinët u mundën dhe si pasojë humbën Jeruzalemin, kanë ndodhur me të vërtetë në pikën më të ulët të Tokës. Ky rajon specifik është shtrati i Detit të Vdekur, apo Liqenit të Lutit, i cili ndodhet në pikën e bashkimit të Sirisë, Palestinës dhe Jordanisë. "Deti i Vdekur" shtrihet 395 metra nën nivelin e detit dhe me të vërtetë është vendi më i ulët në Tokë.²⁵

Kjo nënkupton se bizantinët u mundën në pjesën më të ulët të Tokës, ashtu siç thuhet në Kuran.

Pjesa më rëndësishme është fakti se lartësia e Detit të Vdekur mund të matet vetëm me pajisjet teknike moderne. Më parë ishte e pamundur të dihej se ajo ishte pjesa më e ulët e sipërfaqes së Tokës. A nuk është ky një argument bindës se Kurani është me të vërtetë një shpallje hyjnore...



**INFORMACIONET
HISTORIKE
NË KURAN**

FJALA "HAMAN" NË KURAN

Informacioni i dhënë në Kuran rreth Egjiptit të lashtë nxori në dritë shumë fakte historike, të cilat ishin të pakonfirmuara deri kohët e fundit. Këto fakte na bëjnë të qartë se çdo fjalë në Kuran është shpallur nga një Ekzistencë Inteligjente me Urtësi të përkryer.

Hamani është një person, emri i të cilit përmendet në Kuran së bashku me Faraonin. Ai është përmendur në gjashtë vende të ndryshme në Kuran si një prej njerëzve më të afërt të Faraonit.

Çuditërisht, emri i Hamanit nuk përmendet fare në Teurat (Tora), megjithëse në të historia e Musait (Moisiut) është dhënë shumë e detajuar. Megjithatë, emrin Haman e gjejmë të përmendur te kapitujt e fundit të Testamentit të Vjetër, ku identifikohet si një prej ndihmësve të mbretit të Babilonisë, i cili u shkaktoi mjaft mizori izraelitëve, afërsisht 1100 vjet mbas vdekjes së Moisiut.

Disa jomuslimanë deklarojnë se Profeti Muhamed e shkroi vetë Kuranin, duke kopjuar Biblën, mirëpo gjatë këtij procesi ai deformoi disa nga ngjarjet e shpallura në Bibël.

Absurditeti i këtyre deklaratave u vërtetua përfundimisht pas deshifrimit të alfabetit hieroglif egjiptian, rreth 200 vjet më parë dhe në shkrimet e lashta u gjend emri "Haman". Më parë, shkrimet dhe dorëshkrimet e Egjiptit të lashtë nuk mund të kuptoheshin. Shkrimi i Egjiptit të lashtë ishte hieroglifik, i cili mbijetoi ndër vite me radhë. Sidoqoftë, me shtrirjen e krishterimit dhe ndikimit të kulturave të tjera në shekujt II dhe III e.s., Egjipti e braktisi besimin e tij të hershëm bashkë me shkrimin hieroglif. Ekzemplari i fundit i njohur, në të cilin ishte përdorur shkrimi i hieroglifëve është një dorëshkrim i vitit 394 e.s. Më pas, ajo gjuhë u harrua dhe askush nuk mund ta lexonte apo kuptonte atë. Kjo gjendje vazhdoi deri 200 vjet më parë...

Misteri i gjuhës së lashtë së hieroglifëve egjiptiane u zgjidh më 1799, pas zbulimit të pllakës *Rosetta Stone*, e cila i përkiste vitit 196 p.e.s. Rëndësia e



Emri "Haman" nuk njihet derisa u deshifrua gjuha hieroglifike egjiptiane në fillim të shekullit XIX. Kur kjo gjuhë u deshifrua, u bë i njohur fakti se Hamani ishte ndihmësi i afërt i Faraonit dhe ishte "përgjegjës i atyre të cilët nxirrnin shkëmbinj". (Lart tregohen ndërtuesit e lashtë egjiptianë). Në Kuran, Hamani është përmendur si personi që drejtonte punët ndërtuese nën komandën e Faraonit. Kjo nënkupton se ky lajm nuk mund të njihet nga askush në kohën kur u shpall Kurani, aq më tepër që edhe vetë Bibla, megjithëse ajo është shumë më e detajuar se Kurani në përshkrimin e ngjarjeve, nuk e përmend një gjë të tillë.

këtij dorëshkrimi qëndron në faktin se ai ishte shkruar në tri forma të ndryshme: hieroglifike, demotike (një formë e thjeshtuar e shkrimit të priftërijeve në Egjiptin e lashtë) dhe greke. Me ndihmën e dorëshkrimit grek u deshifruan shkrimet e lashta egjiptiane. Përkthimi i dorëshkrimit u bë nga francezi Jean-Françoise Champollion. Kështu, një gjuhë e harruar dhe shumë ngjarje të lidhura me të dolën në dritë. Në këtë mënyrë, u përfunduan mjaft njohuri mbi qytetërimin, fenë dhe jetën sociale të Egjiptit të lashtë.

Nëpërmjet deshifrimit të hieroglifëve u zbuluan njohuri mjaft të rëndësishme. Një prej tyre ishte përmendja e emrit "Haman" në dorëshkrimet egjiptiane. Ky emër gjendet në monumentin e muzeut Hof Museum, në Vjenë.

Në fjalorin "Njerëzit në mbretërinë e re", i cili u përgatit duke u bazuar mbi tërë përmbledhjet e dorëshkrimeve, përmendet se Hamani ka qenë "përgjegjës i punëtorëve të cilët nxirrnin shkëmbinj".²⁶

Rezultati nxori në pah një të vërtetë mjaft të rëndësishme. Ndryshe nga pohimet false të kundërshtarëve të Kuranit, Hamani ka jetuar në Egjipt në kohën e Musait, si njeri i afërt me Faraonin dhe ka marrë pjesë në ndërtimet e kryera, siç thuhet edhe në Kuran.

Për më tepër, ajeti kuranor përshkruan ngjarjen ku Faraoni i kërkoi Hamanit të ndërtonte një kullë të lartë.

“ Faraoni tha: “O ju krerët e popullit! Unë nuk

di të keni ndonjë zot tjetër përveç meje, ndaj ti o Haman, prodho për mua tulla, duke pjekur baltën dhe ndërtomë një kullë të lartë, ndoshta

do të arrij të shoh zotin e Musait, megjithëse unë mendoj se në të vërtetë ai është gënjeshtar.”

(El Kasas 38)

Si përfundim, ekzistenca e emrit të Hamanit në dorëshkrimet e Egjiptit të lashtë, jo vetëm që i bëri të pavlera thëniet e fabrikuara të mohuesve të Kuranit, por gjithashtu konfirmoi edhe një herë faktin se Kurani është fjala e Allahut, Zotit të botëve.

TITUJT E SUNDUESVE EGJIPTIANË NË KURAN

Musai nuk ishte i vetmi profet që jetoi në tokat e Egjiptit gjatë historisë së lashtë të vendit. Profeti Jusuf (Jozef) jetoi në Egjipt shumë kohë para se të vinte Musai.

Kur lexojmë historitë e Musait dhe Jusufit, ne hasim një lloj paralelizmi. Ndërsa i adresohemi sunduesit të Egjiptit në kohën e Jusufit, gjejmë të përdorur në Kuran epitetin "melik" (mbret):

**“ Mbreti tha: “Sillmani Jusufin,
që ta bëj prej njerëzve të afërt me mua!” (Kur ia sollën)
dhe bisedoi me të tha: “Tani ti ke një pozitë të lartë
te ne dhe je i besueshëm. ”**

(Jusuf 54)

Në kontrast, sunduesi në kohën e Musait nuk quhet më mbret por "Fir'aun" (Faraon):

**“ Ne i dhamë Musait nëntë mrekulli të qarta.
Pyeti (o Muhammed) bijtë e Israilit (për Musain) kur u
erdhi atyre, mirëpo faraoni i tha atij: O Musa,
unë mendoj se ti je i magjepsur! ”**

(El Isra 101)

Ngjarjet historike të evidentuara sot na tregojnë shkakun e emërtimit të ndryshëm të këtyre sunduesve. Fjala "faraon" në të vërtetë ishte emri i pallatit mbretëror në Egjiptin e hershëm. Sunduesit e dinastisë së vjetër nuk e përdornin këtë emër. Fjala faraon, si një titull sunduesi, nuk u përdor deri në periudhën e "Mbretërisë së Re" të historisë së Egjiptit. Kjo periudhë filloi me dinastinë e tetëmbëdhjetë (1539-1292 p.e.s.) dhe që prej dinastisë së njëzetë (945-730 p.e.s.) fjala faraon përdorej si një titull nderi.²⁷

Kështu pra, mrekullia e Kuranit demonstron edhe një herë: Jusufi jetoi



në kohën e Mbretërisë së Vjetër dhe atëherë përdorej fjala "melik" (mbret) për sunduesit egjiptianë dhe jo "faraon". Nga ana tjetër, Musai jetoi në periudhën e Mbretërisë së Re, kur sunduesit e Egjiptit quheshin "faraonë".

Nuk ka dyshim se një dallim i tillë mund të bëhej vetëm nga dikush që e njihnte mirë historinë e Egjiptit. Por për fat të keq, historia e Egjiptit të Lashtë u harrua krejtësisht që prej shekullit IV. Për këtë arsye, hieroglifet nuk mund të kuptoheshin më, ndaj dhe ky fakt nuk mund të zbulohet para shekullit XIX. Si rrjedhim, askush nuk kishte njohuri kaq të thella mbi historinë e Egjiptit të lashtë, në kohën kur u shpall Kurani. Ky është një tjetër fakt që vërteton qartë se Kurani është fjala e Zotit.

A vibrant, scenic landscape featuring a waterfall cascading into a pool of clear, turquoise water. Several white swans are swimming in the water. The scene is framed by lush green foliage and large white flowers with yellow centers, possibly orchids, in the foreground and background. The overall atmosphere is peaceful and natural.

KONKLUSION

Të gjitha këto mrekulli që shqyrtuam më sipër vërtetojnë qartë se Kurani është një libër, në të cilin çdo gjë e shpallur është provuar të jetë e vërtetë. Faktet rreth temave shkencore, lajmet mbi të ardhmen dhe përshkrimi i historive të ndodhura në kohët e lashta tregojnë se askush nuk mund t'i njihje ato në kohën e shpalljes së Kuranit. Kjo na vërteton bindshëm një gjë: se Kurani nuk ka mundësi të jetë fjalë e njeriut, ai është fjala e Zotit të Plotfuqishëm, Krijuesit të gjithçkaje, dija e të Cilit përfshin çdo gjë. Në një ajet kuranor, Zoti thotë **"Sikur Kurani të ishte prej dikujt tjetër, përveç Zotit, njerëzit do të gjenin në të shumë kundërthënie."** (En-Nisa 82) Jo vetëm që kundërthëniet nuk ekzistojnë në Kuran, por shumë pjesë të këtij Libri të Shenjtë përmbajnë mrekulli të ndryshme, të cilat zbulohen dita-ditës.

Njerëzimi duhet të kapet fort pas këtij libri hyjnor të shpallur nga Zoti dhe ta pranojë atë si udhëzimin e tij të vetëm. Në një nga ajetet kuranore, Zoti na bën thirrje:

"
Këtë libër ne e bëmë dobiprurës e të begatshëm,
ndaj përmbajuni atij dhe ruajuni (nga gjynahet),
me qëllim që të mëshiroheni. "
(El-En'am 155)

Në një ajet tjetër, Zoti tërheq vërejtjen:

"
Thuaj: "E vërteta është ajo që vjen nga Zoti juaj, ndaj kush
të dojë, le të besojë dhe kush të dojë, le të mohojë. "
(El Kehf 29)...

"
Në të vërtetë këto janë këshilla. Kush dëshiron,
merr mësim nga ky Kuran. "
(Abese 11-12)



DISFATA E EVOLUCIONIT

Për informacione më të hollësishme rreth kësaj teme, mund t'i referoheni librit "Gjunjëzimi i Evolucionit" i të njëjtit autor. Ky libër është botuar edhe në gjuhën shqipe.

Dështimi shkencor i Darwinizmit


Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet nga grekët e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin XIX. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit *Origjina e Specieve*. Në këtë libër Darvini doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darwinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor objektiv. Ashtu siç tregohet edhe në kapitullin me titull “Vështirësitë e Teorisë” në të njëjtin libër, teoria linte hapësira të mëdha përballë një sërë pyetjeve shumë të rëndësishme.

Darvini shpresonte që vështirësitë që i dilnin teorisë do të kapërceheshin me zhvillimin e shkencës dhe zbulimet e reja shkencore do ta forconin atë edhe më tepër, gjë të cilën e deklaronte shpesh në libër. Por shkencë përparonte plotësisht në kah të kundërt me shpresat e Darwinit dhe në vend që ajo t’i përkrahte hipotezat themelore të teorisë, i shtoi akoma dhe më tepër pikëpyetjet rreth kësaj teorie.

Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk shpjegon kurrë se si ka filluar fillimisht jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që provon se “mekanizmat e evolucionit”, të propozuara nga kjo teori, kanë ndonjë forcë evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë të kundërtën e ideve të parashtruara nga teoria e evolucionit.

Le të shtjellojmë në vija të përgjithshme këta tre tituj:



Pengesa e parë: Origjina e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në një tokë primitive afërsisht 3.8 miliardë vjet më parë. Pyetja që nuk mund ta shpjegojë teoria është se si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile? Por në fillim, duhet të ndalojmë në shkallën e parë të procesit të evolucionit: Si u shfaq “qeliza e parë”?

Teoria e evolucionit, megjë e refuzon krijimin dhe nuk pranon asnjë ndërhyrje të mbinatyrshme, supozon se qeliza e parë është shfaqur rastësisht në mënyrë aksidentale pa asnjë projektim apo planifikim. D.m.th., sipas teorisë, lëndët inorganike duhen të kenë nxjerrë në dritë rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më themelore të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur fare mbi origjinën e jetës, sepse koncepti primitiv në periudhën kur jetoi ai supozonte që gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë elementar. Sipas teorisë së “lindjes së rastësishme” që besohej në mesjetë, lëndët inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se buburrecat formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një farë kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte një argument që provonte se jeta rrjedh prej lëndëve inorganike. Por më vonë do të kuptohej se ato krimba mbi mishin nuk formoheshin aksidentalisht, por nga larvat



Lui Pastër me eksperimentet që kreu e bëri të pavlefshëm pretendimin mbi “formimin e jetës nga lëndët inorganike”, bazë kjo e teorisë së evolucionit.

që silleshin nga mizat.

Në periudhën që Darvini shkroi librin “Origjina e Specieve”, besimi se bakteriet formoheshin nga lëndë inorganike shihej si një ide e pranuar gjerësisht në botën e shkencës. Por vetëm 5 vjet pas botimit të librit të Darvinit, biologu i shquar francez Lui Pastër e çrrënjosi plotësisht këtë besim, i cili përbënte bazat e evolucionit. Përfundimi i arritur pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata, ishte si më poshtë:

“Pretendimet se lëndët inorganike mund të formojnë jetë u varrosën plotësisht në histori.”²⁸

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit, i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pastërit, mirëpo shkencë, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi lindjen e rastësishme të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit XX

Evolucionisti i parë, i cili mori në dorë çështjen e origjinës së jetës në shekullin XX ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të formohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej të bënte këtë rrëfim: *“Origjina e qelizës fatkeqësisht përbën pikën më të errët të gjithë teorisë së evolucionit.”²⁹*

Evolucionistët që ndoqën rrugën e Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje mbi origjinën e jetës. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai i organizuar në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazet, që pretendoheshin se ekzistonin në atmosferën primitive dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, formoi disa molekula organike (aminoacide) që përdoren në ndërtimin e proteinave.

Ky eksperiment, i cili në ato vite paraqitej si një fazë e rëndësishme e evolucionit, pas disa vitesh u bë tërësisht i pavlefshëm, pasi u zbulua se “atmosfera” e përdorur në eksperiment ishte shumë e ndryshme nga atmosfera reale e tokës.³⁰

Pas një periudhe të gjatë qetësie, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte aspak reale.³¹



Përpjekjet e Aleksandër Oparinit për t'i dhënë një shpjegim origjinës së jetës përfunduan me dështim të plotë.

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit XX për të zgjidhur problemin e origjinës së jetës përfunduan pa sukses. Jeffrey Bada, gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips, San Diego, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën evolucioniste “Earth”, këtë të vërtetë e pohon kështu:

“Sot, duke e lënë pas shekullin XX, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në këtë shekull: Si filloi jeta në tokë”?³²



Më në fund u pranua edhe nga burimet evolucioniste që origjina e jetës është akoma një dilemë e madhe për teorinë e evolucionit.

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi origjinën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë, është ndërtimi jashtëzakonisht i ndërlikuar i gjallesave, të cilat më parë supozoheshin se zotëronin një ndërtim elementar. Qeliza është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Edhe nëse përdorim laboratorin më të përparuar të botës, duke grupuar përbërje inorganike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përftojme një qelizë të vetme.

Kushtet që duhen të krijohen për shfaqjen e qelizës janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Molekula e ADN^{-së} përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN^{-ja} e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili. Probabiliteti që proteinat (njësia bazë e qelizës) të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen “të pamundura”.

Padyshim, nëse formimi i rastësishëm i jetës është i pamundur, atëherë do të na duhet të besojmë se jeta është “e krijuar” nga një fuqi e mbinatyrshme. Profesori i Astronomisë dhe Matematikës së Aplikuar në Universitetin e Kardifit, Chandra Uickramasinge, një shkencëtar, i cili për 10 vjet me radhë ka besuar se jeta s’është e krijuar, e shpjegon në këtë mënyrë këtë të vërtetë:

“Gjatë gjithë studimeve të mia si shkencëtar, i kam qëndruar tepër strikt idesë që shkenca kurrë nuk do të pajtohet me nocionin e krijimit të vetëdijshëm. Këtë

koncept duhet ta mohojm me forcë... Por tani, nuk mund të gjej asnjë argument për ta hedhur poshtë... Ne jemi mësuar të arsyetojmë me një mentalitet të hapur dhe tani përgjigja e vetme logjike që mund të jepet mbi ekzistencën e jetës në tokë është krijimi..."

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Pengesa e dytë që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se "të dy mekanizmat e supozuar të evolucionit", nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në mekanizmin e "seleksionimit natyror". Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit "*Origjina e Specieve nëpërmjet seleksionimit natyror*".

Seleksionim natyror do të thotë përzgjedhje e natyrës. Ai mbështetet në logjikën se, të përfshirë në luftën për mbijetesë, në natyrë do të mbesin gjallë vetëm ato gjallesa që i përshtaten më mirë kushteve natyrore dhe fizike. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbesin gjallë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet vetëm nga individë të fortë dhe të shpejtë. Sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të ndërhyjë në evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë ato p.sh. në kuaj. Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj dhe në librin e tij *Origjina e Specieve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror është i pavlefshëm, nëse nuk shfaqen shanset e favorshme.*³³

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formohen këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej duke u mbështetur te Lamarku. Sipas këtij biologu francez, i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcjellin brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, që cilat kanë përjetuar gjatë jetës së tyre. Si përfundim i akumulimit të këtyre cilësive brez



Një nga faktet që e bën të pavlefshme teorinë e evolucionit është struktura tepër e ndërlukuar e gjallesave. Molekula e ADN³² që merr pjesë në bërthamën e qelizës është shembull i kësaj. ADN³² është një bankë informacioni ku ruhen të gjitha veçoritë fizike përkatëse të një gjallese. Nëse do të hidhnim në letër informacionet që përmban ADN³² e njeriut, do të formohej një enciklopedi me afërsisht 900 vologe. Sigurisht që një informacion i tillë i jashtëzakonshëm, e bën të pavlefshëm në mënyrë të prerë konceptin e rastësisë.

pas brezi, dalin në ekzistencë specie të reja. P.sh., sipas Lamarkut, xhirafat kanë evoluar nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta duke zgjatur qafën.

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm në librin e tij, ku pretendon se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit janë shndërruar në balena.³⁴

Por me zbulimet e Mendelit dhe me zhvillimin e njohjes së ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencat e gjenetikës në shekullin XX, u shemb plotësisht legjenda e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Mutacionet dhe neo-darvinizmi

Në këtë gjendje, darvinistët, për të gjetur një zgjidhje, nxorën në dritë në fund të viteve 30' "Teorinë Sintetike Moderne", apo siç njihet ndryshe neo-darvinizmin, i cili i konsideroi mutacionet, krahas seleksionimit natyror, si "shkaqe të ndryshimeve të dobishme". Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është neo-darvinizmi.

Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u shfaqën si rezultat i mutacioneve, apo gabimeve gjenetike në organet e ndërlikuara të këtyre gjallesave si veshët, sytë, mushkëritë apo krahët. Por ekziston një fakt shkencor që e hedh poshtë teorinë: **Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, gjithmonë i dëmtojnë ato.**

Arsyeja është shumë e thjeshtë: ADN^{ja} zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar. Çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund të shkaktojë vetëm dëme. Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si më poshtë:

"Mutacionet janë të vogla, të rastësishme dhe të dëmshme. Shfaqen shumë rrallë dhe mundësia më e madhe është që ato të mos kenë efekt. Këto karakteristika tregojnë se mutacionet nuk mund të sjellin zhvillime evolutive. Një ndryshim i rastësishëm në një organizëm tejet kompleks është ose i paefektshëm ose i dëmshëm. Një ndryshim i rastësishëm që mund të ndodhë në një orë dore nuk do ta zhvillonte atë. Mundësia më e madhe është që ky ndryshim të jetë i dëmshëm e, në rastin më të mirë, i paefektshëm. Një tërmet nuk e zhvillon një qytet, por vetëm e shkatërron..."³⁵

Deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm. Dihet se mutacionet, të cilat teoria e evolucionit i paraqet si "mekanizma evoluese" janë raste

Evolucionistët që prej fillimit të këtij shekulli, duke krijuar mutacione të ndryshme në insekte, u munduan të zbulonin një mutacion të dobishëm. Por përfundimi i vetëm i arritur nga rezultatet e përpjekjeve dhjetra-vjeçare ishte vetëm insekte të sëmura, të gjymtuara dhe të mangëta. Pranë kemi kokën e një insekti normal dhe në të djathtë të tij një insekt që ka pësuar mutacion.



gjenetike që i shkatërrojnë dhe i lënë të gjymtuara gjallesat. (Ndikimi më i shpeshtë i mutacioneve të njerëzit janë kanceret.) Sigurisht që një mekanizëm shkatërrues nuk mund të ketë efekte evoluese, kështu që edhe seleksionimi natyror, ashtu siç pohon edhe Darvini, “i vetëm s’mund të bëjë asgjë”. Ky realitet na bën të besojmë se në natyrë nuk ekziston asnjë mekanizëm evolues, ndaj dhe ai përfytyrim imagjinar që e quajmë evolucion nuk është përjetuar në asnjë periudhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që pretendohet nga teoria evolucionit nuk është përjetuar kurrë. Sipas teorisë, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga njëra-tjetra. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, kthehej në një urë kalimi për formimin e një specieje tjetër dhe në këtë mënyrë janë shfaqur të gjitha speciet e tjera. Sipas teorisë, ky transformim u krye gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Brenda këtij intervali të gjatë transformimi, duhet të jenë formuar dhe të kenë jetuar miliarda “specie kalimtare”. P.sh., në të kaluarën duhet të ketë ekzistuar një specie gjysmë peshk–gjysmë zvarranik, apo gjysmë zog-gjysmë zvarranik. Meqë ajo ishte një periudhë transformimi, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë defektesh. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajmë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë larmia dhe numri i tyre do të ishte shumë herë më i madh se larmia dhe numri i specieve ekzistuese. Kështu që mbetjet e këtyre specieve të çuditshme do të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin e tij, këtë fakt e shpjegon kështu:

“Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të



Teoria e evolucionit mbron tezën se speciet e gjalla kanë evoluar nga njëra-tjetra gradualisht me ndryshime të vogla. Faktikisht të dhënat fosile e përgënjeshtërojnë hapur këtë pretendim. P.sh. në Epokën e Kambrianit, e cila filloi 530 milionë vjet më parë, janë shfaqur njëkohësisht dhjetra specie të ndryshme nga njëra-tjetra. Gjallesat, të cilat i përkasin kësaj epoke (të përshkuara në foton e mësipërme), zotërojnë një strukturë tepër të komplikuar. Ky fakt, i cili në gjuhën gjeologjike emërohet si "Shpërthimi i Kambrianit", është një argument i qartë i krijimit.

njëtit grup, duhet të kenë ekzistuar... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre në të shkuarën mund të gjenden vetëm në mbetjet fosile.”³⁶

Shpresat e venitura të Darvinit

Nga mesi i shekullit XIX e deri më sot, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive mbi fosilet, kurrë nuk janë gjendur forma kalimtare. Të gjitha zbulimet e kryera nga gërmimet dhe kërkimet e ndryshme, në kundërshtim me shpresat e evolucionistëve, tregojnë se gjallesat janë shfaqur rastësisht, të përsosura dhe pa mangësiira.

Paleontologu i njohur anglez Derek Ager, edhe pse ishte një evolucionist, u detyrua ta pohonte këtë realitet:

“Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji për llogari të një tjetri.”³⁷

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa forma të ndërmjetme mes tyre. Kjo është pikërisht e kundërta e asaj që parashikoi Darvini. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar, sepse i vetmi shpjegim që një specie e gjallë të

Fosili Harengë 54 milion vite më parë
Harengë e ditëve tona

Të dhënat fosile janë një pengesë e madhe për teorinë e evolucionit, sepse me informacionet që na japin, tregojnë se midis specieve të gjalla nuk ka asnjë formë kalimtare dhe se ato janë shfaqur individualisht dhe spontanisht. Ky fakt është provë se të gjitha speciet janë të krijuara veç e veç.

shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar, duhet të jetë që speciet janë krijuar. Kjo e vërtetë është pranuar nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

“Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose janë zhvilluar gradualisht. Në rast se janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato duhet të jenë krijuar nga ndonjë inteligjencë e plotfuqishme...”³⁸

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në botë të formuara plotësisht e përsosmërisht. Me fjalë të tjera **“origjina e llojeve”, në kundërshtim me atë që mendonte Darvini, është krijimi dhe jo evolucioni.**

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë rrjedhur nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Në këtë periudhë, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Në fakt, ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar imagjinar:

1. Australopitekët
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë majmunor të njeriut. Këto qenie të gjalla nuk ishin në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lord Solly Zuckerman dhe profesorit Charles Oxnard, dy anatomistë me famë botërore nga Britania dhe SHBA^{ja}, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji majmuni të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.³⁹

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo” ose “klasa njerëzore”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë

Maska të improvizuara prej evolucionistëve



Nuk ekziston asnjë mbetje fosile që të mbështesë përrallën e evolucionit të njeriut. Në të kundërt, të dhënat fosile tregojnë se mes njerëzve dhe majmunëve ekziston një kufi i pakapërcyeshëm. Të përballur me këtë fakt, evolucionistët i lidhën shpresat pas disa vizatimeve dhe ndërtimeve imagjinare. Mbetjeve fosileve, ata u mvishnin maskat që dëshironin dhe formonin fytyra imagjinare gjysmë-majmun e gjysmë-njeri.

njëra-tjetrës dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Mayr, një prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e XX e pranon këtë duke thënë: “Zinxhiri që arrin deri te *Homo sapiens* në fakt ka humbur.”⁴⁰

Kur përmendin zinxhirin **Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens**, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Australopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në rajone të ndryshme të botës.⁴¹

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohët moderne. Neandertalët dhe Homo Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtën zonë.⁴²

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të

njëra-tjetër. Stephan Jay Gould, një prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilën gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Ç'mund t'i ndodhë shkallëzimit tonë, nëse bashkëkzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitek dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit në tokë.⁴³

Me pak fjalë, vizatimet e krijesave imagjinare "gjysmëmajmun-gjysmënjeri", që shfaqen në media apo librat shkollorë dhe, njëkohësisht, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë vetëm me metoda propagandistike, s'janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lord Solly Zuckerman, një nga shkencëtarët më të njohur e të spikatur, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se në të vërtetë nuk ekziston asnjë pemë familjare midis majmunit dhe njeriut.

Zuckerman gjithashtu ka bërë një "radhitje të shkencave". Ai ndërtoi një "spektër" të shkencave, duke i radhitur ato, sipas mendimit të tij, nga ato më shkencoret tek ato më jo-shkencoret. Sipas këtij spektri, më shkencoret, duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, ishin fizika dhe kimia. Më pas vinin shkencat biologjike dhe pastaj ato sociale. Në fund fare, në pjesën e konsideruar si "më jo-shkencore", krahas koncepteve të "perceptimit jashtëshqisor" dhe "shqisës së gjashtë", vendosej dhe "evolucioni i njeriut". Zuckerman shpjegon arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim kuadrin e së vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të supozuara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtëshqisor apo **interpretimi i historisë së fosileve të njeriut. Për ndjekësit e këtyre ideve nuk ekziston asgjë e pamundur. Ata janë të gatshëm të besojnë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.**⁴⁴

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veç një përmbledhje e "disa interpretimeve të paragjykuara" të disa njerëzve që ndjekin verbërisht idetë e tyre.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?".

Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet qendra e shikimit. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh.

Duke u bazuar në këto njohuri, le të mendojmë pak: Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë që pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë me anë të kësaj errësire të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa as teknologjia e shekullit XX nuk ka arritur ta realizojë. P.sh. shikoni librin që lexoni, pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani i televizorit më të zhvilluar i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër.

Për më tepër se 100 vjet, mijëra inxhinierë janë përpjekur të arrijnë këtë qartësi. Janë ndërtuar fabrika, janë bërë shumë kërkime, plane e projekte, megjithatë, po të shikoni ekranin e televizorit dhe librin që mbani në duar, do të shihni se ka një ndryshim të madh në qartësi dhe mprehtësi. Për më tepër, ekrani i televizorit tregon një imazh dy-dimensional, ndërsa me anë të syrit, njeriu është në gjendje të shohë imazhe tre-dimensionale.

Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikën një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale. Për më tepër, bëhet fjalë për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot? N.q.s. një paisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë

është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht.

E njëjta gjë ndodh edhe me veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton për nga veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri. Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë melodi të mrekullueshme apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, shikojmë se një qetësi absolute mbizotëron atje.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfutur asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto paisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI, gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, të mprehtë e të qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Një besim materialist

Ajo që kemi studiuar deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës nuk pranohet nga shkenca. Mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë efekt evolutiv, ndërsa të dhënat fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Në këtë rast, teoria e evolucionit duhet të hidhet tej, sepse është një ide që bie në kundërshtim të hapur me shkencën.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të kësaj teorie si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë..?


Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Liuontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj shkencëtar" me këto fjalë:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materialiste, edhe nëse janë kundër intuitës. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.⁴⁵

Këto fjalë janë deklaratë e qartë se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Ajo predikon se lënda pa jetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo pranon që miliona specie të gjalla, si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, apo qeniet njerëzore u shfaqën si pasojë e ndikimit të fenomeneve fizike (shiu dhe rrufeve) mbi lëndën në natyrë. Ky besim është në kundërshtim të plotë me logjikën dhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që "mos të lejojnë daljen në skenë të një Qenieje Hyjnore."

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Krijuesi është Zoti, i cili krijoi të gjithë universin nga asgjëja, i cili e projektoi atë në mënyrën më të përkryer dhe krijoi e i dha formë të gjitha gjallesave.



*Engjëjt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”
(El-Bekare 32)*

SHENIME

1. S. Waqar Ahmed Husaini, *The Quran for Astronomy and Earth Exploration from Space*, 3rd ed. (New Delhi: Goodword Press: 1999), 103-108.
2. "Edwin Hubble;" www.time.com/time/time100/scientist/profile/hubble.html
3. World Book Encyclopedia, 2003; contributor: Kenneth Brecher, Ph.D., Professor of Astronomy and Physics, Boston University.
4. *Science and Technology Journal*, July 1983.
5. "The Incredible Design of the Earth and Our Solar System;" www.godandscience.org/apologetics/designss.html
6. Carolyn Sheets, Robert Gardner, and Samuel F. Howe, *General Science*, (Newton, MA: Allyn and Bacon Inc., 1985), 305.
7. National Geographic Society, *Powers of the Nature*, Washington D.C. 1978, fq.1213
8. Sheets, Gardner, and Howe, *General Science*, 305.
9. *Powers of Nature*, (Washington D.C.: National Geographic Society: 1978), 12-13.
10. Kazi, 130 Evident Miracles in the Qur'an, 110-111; and www.wamy.co.uk/announcements3.html, from Prof. Zighloul Raghib El-Naggar's speech.
11. Henning Genz, "Nothingness: The Science of Empty Space," 205, www.2think.org/nothingness.shtml
12. Richard A. Anthes, *The Atmosphere*, 3rd ed., (Columbus: Charles E. Merrill Publishing Company: 1981), 268-269; Albert Millers, Jack C. Thompson, *Elements of Meteorology*, 2nd ed., (Columbus: Charles E. Merrill Publishing Company: 1975), 141.
13. Anthes, *The Atmosphere*, 269; Millers, and Thompson, *Elements of Meteorology*, 141-142.
14. Richard A. Davis, *Principles of Oceanography*, (Don Mills, Ontario: Addison-Wesley Publishing Company), 92-93.
15. Danny Elder, and John Pernetta, *Oceans*, (London: Mitchell Beazley Publishers: 1991), 27.
16. M. Grant Gross, *Oceanography, A View of Earth*, 6th ed., (Englewood Cliffs: Prentice-Hall Inc.: 1993), 205.
17. Rod R. Seeley, Trent D. Stephens, and Philip Tate, *Essentials of Anatomy & Physiology*, 2nd ed., (St. Louis: Mosby-Year Book Inc.: 1996), 211; Charles R. Noback, N. L. Strominger, and R. J. Demarest, *The Human Nervous System, Introduction and Review*, 4th ed., (Philadelphia: Lea & Febiger: 1991), 410-411.
18. Seeley, Stephens, and Tate, *Essentials of Anatomy & Physiology*, 211.
19. Keith L. Moore, et al., *Human Development as Described in the Qur'an and Sunnah*, (Makkah: Commission on Scientific Signs of the Qur'an and Sunnah, 1992), 36.
20. Keith L. Moore, *Developing Human*, 3rd ed. (W. B. Saunders Company: 1982), 364a.
21. Williams P., *Basic Human Embryology*, 3rd ed., 1984, 64.
22. "High-Risk Newborn-The Benefits of Mother's Own Milk," University of Utah Health Sciences Center; www.uuhsc.utah.edu/healthinfo/pediatric/Hrnewborn/bhrnb.htm
23. "What is a fingerprint?" www.ridgesandfurrows.homestead.com/fingerprint.html
24. "Heraclius," Wikipedia; <http://en.wikipedia.org/wiki/Heraclius>
25. "The Lowest Part on the Face of the Earth," www.beconvinced.com/science/QURANLOWEST.htm.

26. Hermann Ranke, *Die Ägyptischen Personennamen, Verzeichnis der Namen* (The Egyptian Family Names, Listing of the Names), Verlag Von J J Augustin in Glückstadt, Band I, 1935, Band II, 1952.
27. Elias Karîm, "Qur'anic Accuracy vs. Biblical Error: The Kings & Pharaohs of Egypt;" www.islamic-awareness.org/Quran/Contrad/External/josephdetail.html; Dr. Abu Ameenah Bilal Philips, "An Aspect of the Qur'aan's Miraculous Nature;" www.islaam.com/Article.asp?id=40
28. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, New York, Marcel Dekker, 1977, fq. 2
29. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, (1936) New York, Dover Publications, 1953 (Reprint), fq. 196
30. "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, Nov 1982, fq. 13281330
31. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, fq. 7
32. Jeffrey Bada, *Earth*, Feb 1998, fq. 40
33. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, s. 189
34. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, fq. 184
35. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988.
36. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, fq. 179
37. Derek A. Ager, *The Nature of the Fossil Record*, *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, fq. 133
38. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, New York: Pantheon Books, 1983, fq. 197
39. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, New York: Toplinger Publications, 1970, fq. 7594; Charles E. Oxnard, *The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt*, *Nature*, vol 258, fq. 389
40. J. Rennie, *Darwin's Current Bulldog: Ernst Mayr*, *Scientific American*, Dhjetor 1992
41. Alan Walker, *Science*, vol. 207, 1980, fq. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, *botimil*, New York: J. B. Lipincott Co., 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge: Cambridge University Press, 1971, fq. 272
42. *Time*, Nov 1996
43. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30
44. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, New York: Toplinger Publications, 1970, fq. 19
45. Richard Lewontin, *The Demon Haunted World*, *The New York Review of Books*, 9 Jan 1997, fq. 28